

Rashit Zylfiu

*Kandili i
Ramazanit*

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن
قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

*"O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu siç
u ishte urdhëruar atyre para jush, që të bëheni të
devotshëm."*¹

¹ Kur'an, Bekare: 183.

Titulli:

KANDILI I RAMAZANIT

Përgatit dhe përshtati:

Rashit ZYLFIU

Recensent:

Dr. Sedat ISLAMI

Korrektor letrar:

Arjan KOÇI

Ballina&radhitja kompjuterike:

Avni G. GASHI

Boton:

YYYYY

Tirazhi:

000

Botimi i parë:

Ramazan 1438h/Maj 2017

©Të gjitha të drejtat të rezervuara për autorin.

Info: rashitzylfiu@gmail.com

PARATHËNIE

Falënderimi i takon Allahut. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin alejhi selam.

Ramazani është ndër adhurimet më flladitëse për imanin e besimtarëve muslimanë. Përveç peshës së tij si një ndër pesë shtyllat e Islamit, ai në vetvete mban shumë vlera, të cilat i japin një kuptim shumëdimensional në botën e adhurimeve dhe sferave të tjera ku e ushtron ndikimin e tij.

Ramazani jo vetëm për muslimanët por edhe për jomuslimanët mbetet një sfidë joshëse që qysh herët i shtyu ta studiojnë nga kënde të ndryshme, sidomos nga ai mjekësor, madje jo rrallë i ka shtyrë jomuslimanët të provojnë të agjërojnë ditë të caktuara apo edhe të tërë muajin vetëm për ta parë ndikimin e tij në jetën e tyre.

Ramazani krahas gjallërisë që sjell në zemrat e besimtarëve, ne si hoxhallarë na vë para përgjegjësisë që këtë freski t'ua ofrojmë besimtarëve përmes temave të ndryshme që flasin për Ramazanin në përgjithësi.

Edhe këtë vit kemi hartuar për besimtarët një botim special, në brendësinë e të cilit gjenden tridhjetë tema për tridhjetë ditë Ramazani. Ky kontribut modest është një përmbledhje materialesh të ndryshme që kemi shkruar, përkthyer, përmbledhur e përshtatur për besimtarët. Lus Zotin që kjo puhizë ditore të

shërbejë edhe si një katalog udhërrëfyes gjatë ditëve të Ramazanit.

Zot, pranoje prej nesh në peshoren e veprave të mira.
“Na shpërblej ne dhe të gjithë ata që kontribuan për të dalë në dritë ky botim.”

Amin!

Rashit Zylfiu

1. THIRRJA HYJNORE

Falënderimet i takojnë Allahut. Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Pejgamberin Muhamed sal-Allahu alejhi ue sel-lem.

Sa herë që vjen muaji Ramazan, së bashku me të vijnë edhe ndryshimet. A nuk është hëna e re ndryshim, dyert e xhenetit hapen, ato të xhehenemit mbyllen e lidhen shejtanët? Për agjëruesin ka edhe një lutje ekskluzive, që i pranohet në kohën e iftarit, krahas shumë ndryshimeve të tjera.

Atë ditë që vjen Ramazani na thërret thirrja hyjnore:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

*'O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të bëheni të devotshëm.'*²

Nuk ka dyshim se kjo thirrje në vetvete përçon mesazhe e mësimë dhe në thellësinë e saj ka plot margaritarë nga të cilët besimtari përjeton kënaqësinë më të madhe.

Allahu na thërret me thirrjen më të çmuar, me thirrjen e dinjitetit “o besimtarë”. Nuk ka thirrje më

² Kur'an, Bekare: 183.

prestigjioze se kjo. Kjo thirrje na bën të jemi më vigjilentë, të përgjegjshëm, sepse thirrësi është Allahu dhe ftesa po bëhet për një obligim që Ai kërkon prej nesh.

Ata të cilët kanë besuar Allahun, zemrat e tyre i kanë të mbushura me dashuri karshi Tij, të lumtura që pasojnë të vërtetën, që shenjtërojnë ligjet e Allahut duke shpresuar shpërblimin dhe duke iu frikësuar dënimit të Tij, janë ata të cilët i përgjigjen kësaj thirrjeje hyjnore.

Lajmi se me këtë obligim nuk jemi të ngarkuar vetëm ne muslimanët, por edhe popujt para nesh, e bën më të lehtë agjërimitin dhe na motivon të ndihemi krenarë që jemi pjesë e karvanit të kahershëm.

لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ *që të mund të ruheni nga të këqijat*³ është mesazhi dhe mësimi final që muslimani merr nga medreseja e Ramazanit në një muaj gjatë të cilit mundohet të arrijë rezultatin maksimal, që të pajiset me diplomën e devotshmërisë, e cila do ta ndihmojë për t'u përballur me sfidat e jetës dhe për të qenë sa më stabil karshi thirrjes hyjnore.

Zot, të lutem na mundëso të jemi nga ata të cilët u përgjigjen thirrjeve të Tua dhe u qëndrojnë besnikë ftesave që Ti na bën! Amin!

³ Kur'an, Bekare: 183.

2. URTËSIA E AJETIT TË AGJËRIMIT

Allahu thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

*" O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat."*⁴

Kategoritë e njerëzve përballë këtij ajeti janë dy:

- a) Ata që i përgjigjen.
- b) Ata që nuk i përgjigjen.

Urtësia e ajetit

- Kujdesi i Allahut për ne
Sa butësi dhe sa urtësi ka ky ajet, edhe pse Allahu nuk është i varur e as që ka interes te ne. A nuk duhet që ne t'i hapim zemrat tona për këtë thirrje hyjnore?

- Pesha e thirrjes
Allahu thotë: "*O besimtarë!*" Vetë thirrja tregon se pas saj pason diçka me vlerë. E vetmja lidhje e afërsisë tek

⁴ Kur'an, Bekare: 183.

Allahu është imani yt. A ia vlen që njeriu të mos agjërojë për arsye të pavend?

- Fuqia e thirrjes

Allahu na thërret me këtë thirrje duke u përfaqësuar me iman. Nëse të vjen një ftesë, a nuk nxiton ta shikosh për çfarë është ajo ftesë. Përgjigjja është: -Po nxitoj!

- Ndikimi i imanit

Agjërimi është dëshmi e besimit praktik. Nëse nuk agjëron, dije se ke defekt në imanin tënd. Mbaje gjallë imanin duke agjëruar. Ti agjëron për Atë që ke besuar.

- Nuk ka kompromis

Allahu thotë: “*Ju është urdhëruar agjërimi*” (Saum) Muslimani i konsideron ligjet e sheriatit si ligjet kosmologjike të pandryshuara. Ligji i Allahut nuk ndryshon, agjëron apo nuk agjëron ti. Nuk ka kompromis, nuk ka negociata.

- Nuk je i vetëm

Allahu thotë: “*ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush,*”

Udhëtimi është i gjatë dhe nuk nis e as nuk përfundon me ty.

- Finalja e qartë

Allahu thotë: *“që të mund të ruhëni nga të këqijat.”*

Qëllimi final i agjërimit nuk është që ti të dobësohesh në peshë, as të fitosh peshë, por të peshohesh me iman sepse të nevojitet në udhëtimin tënd për xhenet.

3. DEVOTSHMËRIA NË RAMAZAN

Falënderimet i takojnë Allahut. Paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi Pejgamberin Muhamed, mbi familjen e tij, mbi shokët e tij dhe mbi të gjithë besimtarët që ecin hapave të tij deri në Ditën e Gjykimit.

Premtimi më i madh që Allahu u ka dhënë besimtarëve, kur dihet se Allahu nuk e thyen premtimin e Tij, është takimi me Të. Por a do të kenë mundësi ta takojnë dhe ta shohin Allahun të gjithë njerëzit? A ka diçka me të cilën duhet të stolisemi në jetën e kësaj bote për atë ditë të premtuar?

Kur Allahu i Lartmadhëruar ua dha njerëzve këtë premtim të madh, Ai ua dha mundësitë dhe ua lehtësoi rrugët si të arrijnë që në jetën e kësaj bote të përgatiten për ditën e premtuar dhe për t'u stolisur me petkun e devotshmërisë para takimit me Krijuesin e gjithësisë.

وَلِبَاسُ التَّقْوَىٰ ذَٰلِكَ خَيْرٌ

*“Po petku i devotshmërisë, ai është më i miri.”*⁵

Një ndër mundësitë për t'u stolisur me këtë petk është edhe muaji Ramazan, ose më mirë të themi esenca e agjërimit është që njeriu të arrijë devotshmërinë gjatë këtij muaji të shenjtë. Allahu i Madhëruar thotë:

⁵ Kur'an, Al'araf: 26.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ
لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

*'O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.'*⁶

A ka diçka më të mirë sesa që njeriu të jetë i devotshëm dhe të arrijë qëllimin e Allahut dhe porosinë e të parave dhe të fundit?

وَلَقَدْ وَصَّيْنَا الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ مِن قَبْلِكُمْ وَإِيَّاكُمْ أَن اتَّقُوا اللَّهَ

*“Ne i kemi porositur ata që u është shpallur Libri para jush dhe juve: “Frikësojuni Allah.”*⁷

Allahu subhanehu ue teala na ka porositur që të jemi të devotshëm dhe për ta arritur këtë qëllim na ka obliguar me agjërim ashtu siç i ka obliguar edhe popujt para nesh, ngase agjërimi trashëgon devotshmërinë (takvanë).

Takvaja ka kuptimin e preventivës, parandalimit. Takvallah apo devotshmëria ndaj Allahut ka për qëllim largimin apo tentimin për t'u larguar nga shkaqet e dënimit të Allahut, duke u larguar nga ato që ka ndaluar dhe duke pasuar ato që ka urdhëruar.

⁶ Kur'an, Bekare: 183.

⁷ Kur'an, Nisa: 131.

Disa komentatorë ajetin e agjërimit: “*që të mund të ruheni nga të këqijat*”⁸, e kanë komentuar “që të mbrohemi nga mëkatet”.

Kur përmendim fjalën mëkat, ajo përfshin të gjitha gjërat që meritojnë dënimin në këtë botë apo botën tjetër. Muslimani mbrohet me agjërime duke ndaluar veten nga mëkatet.

Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem ka thënë: “*Agjërimi është mburojë.*” Është i tillë sepse të mbron nga mëkatet duke bërë që të vdesë epshi, i cili është motivuesi kryesor që njeriu të bëjë mëkat.

Devotshmëria e plotë përmban në vetvete praktikimin e obligimeve dhe lënien e haramave. Ndodh që bëjnë pjesë edhe gjërat e pëlqyera dhe lënia e gjërave të urryera dhe ky është kulmi i devotshmërisë. Për këtë arsye, Kur’ani është bërë imam dhe udhëzim për njerëzit e devotshëm.

Kur’ani që në fillim, në ajetet e para pas Fatihasë, është cilësuar si

هُدًى لِّلْمُتَّقِينَ

*“Ai është udhërrëfyes për të devotshmit”*⁹

ngase e përgatit nefsin me devotshmëri të plotë.
Agjërues të nderuar!

⁸ Kur’an, Bekare: 183.

⁹ Kur’an, Bekare: 2.

Nëse doni që agjërimi juaj të mundësojë takvallëk të plotë, atëherë agjëroni Ramazanin plotësisht duke u larguar nga çdo gjë që e pengon, që të jetë ashtu si do Allahu dhe si na ka mësuar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Omer bin Abdulazizi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Nuk është takvallëku të agjërosh ditën e të falesh natën, por takvallëk është lënia e asaj që e ka bërë haram Allahu dhe kryerja e obligimeve e kush më pas furnizohet me ndonjë të mirë, ajo është e mirëse-ardhur."

Agjërimi është mejdan i garave për ta arritur takvallëkun "*...që të mund të ruheni nga të këqijat*".¹⁰ Të devotshmit shfrytëzojnë ditët dhe netët e Ramazanit për shtim të imanit në Allahun xhelexhelale, për adhurim dhe llogaritje të vetvetes për fatkeqësitë e kryelartësisë dhe syefaqësisë, që shpesh herë e rrethojnë njeriun dhe ia asgjësojnë veprat në Ramazan dhe jashtë tij.

Të parët tanë e jetonin zemrën e takvallëkut, kuptimet e saj, ngjallnin jetën dhe adhurimet e tyre. Çdo adhurim tek ata kishte shpirt; namazi, duaja, pendimi, përmendja e Allahut, madje edhe agjërimi kishte shpirt.

¹⁰ Kur'an, Bekare: 183.

Agjërues të nderuar!

Ejani me mua të përkujtojmë realitetin e takvallëkut ashtu si të parët tanë e ngjallnin në shpirtat e tyre. Ndoshta do të ngjallë tek ne shpirtin e agjërimit e të jetojmë me të, me kuptimet e këtij muaji të shenjtë.

Omer AbdulAzizi i kishte shkruar dikujt duke i thënë: "Të porosis që t'ia kesh frikën Allahut, që nuk pranon tjetër pos saj dhe nuk mëshiron pos pronarët e saj, saqë shpërblen vetëm për të. Ata që porosisin për takvallaëk janë të shumtë, por ata që punojnë me të janë të paktë. Lus Allahun që të na bëjë ne dhe ju të devotshëm!"

Talk bin Habibi, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: "Takvallëku është të punosh me nënshtrim ndaj Allahut, me dritë nga Allahu, duke shpresuar në shpërblimin e Allahut dhe t'u shmangesh mëkateve me dritën nga Allahu duke iu frikësuar ndëshkimit të Allahut."

Ne duhet të punojmë në Ramazan me nënshtrimin ndaj Allahut duke shpresuar shpërblimin e Tij dhe duke iu frikësuar ndëshkimit të Tij xhelexhelalu. Frika dhe shpresa janë si dy krahët e shpendit për të arritur tek kënaqësia e Allahut.

Le t'i vendosim përpara nesh këto kuptime gjatë agjërimit të këtij muaji.

Ebu Darda, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, duke sqaruar realitetin e takvallëkut ka thënë: "Takvallëku është që robi t'ia ketë frikën Allahut edhe qoftë sa një

grimcë, derisa të largohet edhe nga disa gjëra që ai i sheh hallall duke u frikësuar se mos është haram, që të jetë perde mes tij dhe haramit."

Lexues i dashur!

Mos e përbuz kurrë të mirën, edhe nëse është sa grimca, puno me të. Mos e tolero të keqen, por largohu prej saj. Vëlla, a ke medituar? A je i gatshëm? Kjo kërkon prej teje një vullnet të madh që të arrish shkallën e lartë të takvallëkut në muajin e devotshmërisë.

Është pyetur Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, për takvallëkun dhe pastaj ka pyetur bashkëbiseduesin:

- A ke udhëtuar në një rrugë me gjemba?
- Po - iu përgjigj.
- Si ecje në të?
- Kur i pashë gjembat, largohesha anash apo kaloja pa shkelur mbi to.
- Ky është takvallëku.

Ne do të ballafaqohemi gjatë këtij muaji me gjemba të shumtë në rrugën drejt Allahut. Ramazani është një rast i mirë që të mëson se si duhet t'i tejkalojmë këto gjemba dhe ky është një tjetër kuptim që duhet ta shtojmë në fjalorin tonë gjatë Ramazanit.

Afrimi tek Allahu në Ramazan dhe takvallëku, ky petk me të cilin na duhet të stolisemi për të dalë para

Allahut, nuk arrihet përpos duke u larguar nga harami. Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë: *"Kush nuk i lë fjalët e rrejtshme dhe punën me të, Allahu nuk ka nevojë që ta lërë ushqimin dhe pijen."*

Ebu Hurejra komenton se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *"Agjërimi është mburojë. Nëse dikush nga ju është agjërueshëm, mos të flasë fjalë të ndyra e as të mos bëjë zhurmë. E, nëse dikush e fyen apo e sulmon, le t'i thotë unë jam agjërueshëm."*

Frytet e devotshmërisë

Devotshmëria është shkak për realizimin e qëllimeve të individëve dhe të shoqërisë.

وَمَنْ يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَلْ لَهُ مِنْ أَمْرِهِ يُسْرًا

“E kush i frikësohet Allahut, Ai atij ia lehtëson punën.”¹¹

Është shkak për pranimin e veprave:

إِنَّمَا يَتَقَبَّلُ اللَّهُ مِنَ الْمُتَّقِينَ

“Allahu pranon vetëm prej të devotshmëve.”¹²

Është shkak për dhurimin e diturisë.

“Kini frikë Allahun, se Allahu ju dhuron dituri (të jashtëzakonshme).”¹³

Devotshmëria është shkak për sjelljen e rizkut.

وَيَرْزُقْهُ مِنْ حَيْثُ لَا يَحْتَسِبُ ﴿٢﴾ وَمَنْ يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَلْ لَهُ مَخْرَجًا

¹¹ Kur'an, Talak: 4.

¹² Kur'an, Maideh: 27.

¹³ Kur'an, Bekare: 282.

“E kush u përmbahet dispozitave të Allahut, atij Ai i hap rrugë dhe e furnizon prej nga nuk e kujton fare.”¹⁴

Ndoshta muslimani në Ramazan ndien kënaqësinë e këtij muaji të bereqetshëm dhe anon nga punët e mira. Muslimani ia jep besën Allahut që të arrijë takvallakun duke u munduar ta praktikojë porosinë e Allahut xhelexhelale.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنْتُمْ مُسْلِمُونَ

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!”¹⁵

O Allah, o Zoti ynë, ne të lutemi që të na dhurosh devotshmëri në këtë muaj, të na stolisësh me petkun e devotshmërisë në jetën e kësaj bote dhe të na mundësosh që në këtë muaj ta arrijmë kënaqësinë Tënde dhe takimin me Ty në ditën e premtuar!

¹⁴ Kur'an, Talak: 2-3.

¹⁵ Kur'an, Al'imran: 102.

4. KUPTIMI I DREJTË I AGJËRIMIT

Ajo që na brengos sot është se shumica e muslimanëve e kuptojnë agjërimin gabimisht, jo sipas kuptimeve që na ka mësuar Allahu, Krijuesi i gjithësisë, dhe i Dërguari i Tij, por sipas kuptimeve njerëzore të ngushta dhe interpretimeve të gabuara, si për shembull: pse të agjëroj unë e të tjerët nuk agjërojnë; nuk ka dallim agjërova apo nuk agjërova, i njëjtë jam; privojnë veten nga ushqimi dhe pija e nuk respektojnë etikën e Ramazanit; bëjnë ndryshime në ushqim, pije dhe harxhime të tjera e jo në vetvete; qëndrojnë natën zgjuar dhe ditën e kalojnë në gjumë; agjërojnë dhe nuk falin namaz; agjëron barku e jo gjuha e tyre prej rrenës, shpifjeve dhe përgojimit; agjërojnë vetëm ditë të caktuara si dita e parë, e mesme, Natën e Kadrit dhe të fundit; nuk agjërojnë duke menduar se për këtë mund të paguajnë me të holla.

Këto janë vetëm disa nga të kuptuarit e gabuar të realitetit pse Zoti na e ka bërë obligim agjërimin dhe pasojat janë se këto çojnë në një agjërim jo efektiv apo në braktisjen e tij.

Të nderuar lexues!

Me këta rreshta do të mundohemi të sjellim para jush kuptimin e drejtë të agjërimit.

- Agjërimi është shtyllë e fesë

Agjërimi është shtylla e katërt e fesë. Sa herë që përmendet fjala shtyllë, kuptohet se ajo që qëndron mbi të nuk ka mundësi të qëndrojë pa këtë shtyllë. Si ka mundësi që ti ta llogaritësh veten pjesëtar të fesë islame e nuk agjëron, ndërsa feja jote qëndron mbi këtë shtyllë? A nuk kuptohet vëlla i nderuar se ti po bëhesh shkaktar dhe pjesëmarrës në prishjen e njërës prej shtyllave të fesë nëse nuk e agjëron?

- Agjërimi është adhurim

Agjërimi është adhurim të cilin e vepron për ta pastruar shpirtin, për ta ngjallur atë dhe për ta shtuar imanin dhe për ta përgatitur agjëruenin që të jetë nga besimtarët e devotshëm.

Prandaj agjërueni është i obliguar t'i largojë ato gjëra të cilat e zbehin apo edhe e prishin agjërimin duke ruajtur gjymtyrët nga ajo që Allahu e ka bërë haram ngase agjërimi është adhurim përmes të cilit njeriu afrohet tek Allahu.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë: *"Nuk është agjërimi abstenim vetëm prej të ngrënit dhe të pirit, por agjërimi është zbrapsje nga e kota (fjalë dhe punë) dhe e ndyra. E nëse dikush të ngacmon apo sillet ashpër me ty, thuaji: Unë po agjëroj, unë po agjëroj!"*¹⁶

¹⁶ "Sahihut-targibi vet-tarhibi", Shejh Albani.

Dhe në hadithin tjetër: *“Shumë agjërues nuk kanë dobi nga agjërimi i tyre pos urisë.”*¹⁷

- Agjërimi, trajnim për besimtarët
Ramazani llogaritet si trajnim hyjnor nga Allahu për robërit e Tij besimtarë për t'u trajnuar që të bëjnë vepra të mira dhe të pendohen nga mëkatet. Muslimani e ushtron veten duke agjëruar, falur, duke dhënë sadaka dhe bamirësi në fusha të tjera. Gjithashtu ushtrohet duke i braktisur mëkatet, duke ruajtur shikimin dhe gjuhën. Roli i këtij trajnimi është që ta kthejë besimtarin në origjinalitetin e tij, që pas Ramazanit të jetojë një jetë me iman të plotë dhe ky është sinjal i pranimit të agjërimin.

Por fatkeqësia e madhe është se një pjesë e besimtarëve nuk përfitojnë nga këto trajnime dhe menjëherë pas Ramazanit kthehen në gjendjen e mëparshme, a thua se Allahu adhurohet vetëm në Ramazan.

Allahu thotë:

وَأَعْبُدْ رَبَّكَ حَتَّىٰ يَأْتِيَكَ الْيَقِينُ

*“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja!”*¹⁸

- Agjërimi, rast për pajtim me Allahun

¹⁷ "Sahihut-targibi vet-tarhibi", Shejh Albani.

¹⁸ Kur'an, Hixhër: 99.

Pendimi është një obligim për besimtarët në çdo kohë dhe vend. Allahu na thërret:

وَتُوبُوا إِلَى اللَّهِ جَمِيعًا أَيُّهَ الْمُؤْمِنُونَ لَعَلَّكُمْ تُفْلِحُونَ

“Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin”¹⁹

Allahu e pranon pendimin nga robërit e Tij në çdo vend dhe çdo kohë, por ja që Allahu i Madhëruar ka bërë që në disa kohë pendimi ka më tepër vlerë dhe mundësia që robi të pajtohet me Allahun është agjërimi. Të nderuar, nëse në Ramazan shejtanët janë lidhur, dyert e xhenetit janë hapur, dyert e xheheneimit janë mbyllur, shpirti yt është më afër Allahut, atëherë në këtë muaj je më i gatshëm për të bërë mirë. E, nëse nuk pajtohem me Allahun kur në njëmbëdhjetë muaj kemi bërë mëkate prej të cilave Zoti është hidhëruar me ne, pra nëse nuk pendohemi në Ramazan, kur do të pendohemi? Nëse nuk pajtohem me Allahun në Ramazan, nuk e di se kur do të na jepet rasti të pajtohem! Nëse nuk e fitojmë faljen dhe xhenetin e Allahut, kur do ta fitojmë?

¹⁹ Kur'an, Nur: 31.

- Kuptimi i të parëve tanë mbi agjërimin

Të ndalemi pak dhe të shpalosim diçka nga jeta e të parëve tanë të mirë, që të shikojmë se si ata e kanë kuptuar realitetin e agjërimin.

Omer bin Hatabi thotë: “Nuk është agjërimi vetëm ta privosh veten nga ushqimi dhe pija, por agjërim është ta pastrosh gjuhën tënde nga rrena, e kota dhe fjalët e ndyra.”

Hafsa bint Sirin, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Kur shokët e Pejgamberit agjëronin, qëndronin në xhami dhe thoshin se agjërimi është mburojë derisa të mos digjet. E djegia e saj është përgojimi.”

- Agjërimi është një pamje e Ditës së Gjykimit

I Dërguari i Allahut e kishte dërguar Ebu Musain me një grup në një betejë nëpër det. Në një natë të errët, kur ishin në anije, i ngritën velat, kur papritmas një zë u dëgjua nga lart: “O udhëtarë të anijes, ndaluni t’ju lajmëroj lidhur me një caktim që Allahu ia ka caktuar Vetes!” Ebu Musai tha: “Na trego nëse e di!” Zëri tha: “Vërtet Zoti i Madhëruar ia ka caktuar Vetes ta ngopë me ujë ditën e etjes atë që është etur në një ditë të nxehtë.”²⁰

²⁰ "Sahihut-targibi vet-tarhibi", Shejh Albani.

5. PËR ATË QË E PËRJETON MUAJIN E RAMAZANIT

Falënderimi i takon Krijuesit të botëve, paqja dhe shpëtimi qofshin mbi vulën e Pejgamberëve, Muhamedin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, mbi familjen e tij të pastër dhe mbi shokët e tij të ndershëm.

Me të vërtetë muaji i Ramazanit është një muaj me vlera të mëdha. Këtë muaj Allahu i Lartësuar e ka veçuar nga të gjithë muajt me vlera, cilësi dhe specifika që nuk gjenden te muajt e tjerë.

Në mesin e specifikave dhe vlerave të këtij muaji janë:

1. Zbritja e Kur'anit në këtë muaj.

Allahu i Madhëruar thotë:

شَهْرُ رَمَضَانَ الَّذِي أُنزِلَ فِيهِ الْقُرْآنُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَاتٍ مِّنْ
فَمَنْ شَهِدَ مِنْكُمُ الشَّهْرَ فَلْيَصُمْهُ الْهُدَى وَالْفُرْقَانِ

*’Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues (i së mirës nga e keqja). Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë!’*²¹

²¹ Kur'an, Bekare: 185

Zbritja e Kur'anit në këtë muaj aludon për vlerën dhe vendin e tij të lartë, ngase Kur'ani është fjala e Allahut, libri më me vlerë që ka zbritur Allahu i Lartësuar dhe për zbritjen e tij ka zgjedhur muajin më me vlerë.

Imam Ibën Kethiri ka thënë: “E lavdëron Allahu i Lartësuar muajin e agjërimit nga të gjithë muajt e tjerë ngase e ka zgjedhur nga mesi i tyre për të zbritur Kur'anin Fisnik.”

Dijetari Salih bin Fevzan ka thënë: “Në këtë ajet të ndritur, Allahu ka përmendur për muajin Ramazan dy specifika të mëdha. Specifika e parë është zbritja e Kur'anit në këtë muaj si udhëzues për njerëzimin, që t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë dhe që ta dallojnë të vërtetën prej së kotës me anë të këtij libri fisnik, i cili është i dobishëm për njerëzimin, është shpëtim dhe lumturi në dynja e ahiret. Specifika e dytë është se e bëri obligim agjërimit për umetin e Muhamedit sal-Allahu alejhi ue sel-lem me fjalën urdhëruese të Tij:

فَمَنْ شَهِدَ مِنْكُمُ الشَّهْرَ فَلْيَصُمْهُ

*“Pra, kushdo nga ju që dëshmon këtë muaj, le të agjërojë!”*²²

2. Obligimi i agjërimit në Ramazan.

²² Bekare: 185

Edhe kjo është një prej veçorive të këtij muaji. Allahu i Lartësuar thotë: *"E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le ta agjërojë."* (Bekare:185)

Mënyra urdhërore në këtë ajet kur'anor (le ta agjërojë) aludon për obligimin (farzin) e agjërimin të Ramazanit, që është shtyllë prej shtyllave të Islamit, ibadet prej ibadeteve që Allahu i Lartësuar e ka bërë obligim për robërit e Tij.

Obligimi i tij është saktësuar me Kur'an, Sunet dhe ixhma (konsensus):

1. për çdo musliman,
2. të mençur (që ka aftësi mendore të shëndoshë),
3. moshërritur,
4. vendas (jo udhëtar), që është në gjendje për agjërim, i lirë prej pengesave,
5. mashkull apo femër.

Kush e mohon (kundërshton) obligimin e agjërimin të muajit Ramazan me vetëdije të plotë është murted (i dalë nga feja) dhe prej tij kërkohet që të pendohet dhe të besojë në obligueshmërinë e agjërimin të këtij muaji. Të qenët e Ramazanit shtyllë prej shtyllave të Islamit aludon për vlerën dhe rëndësinë e tij, për arsye se shtylla është bazë e ndërtimit të një gjëje dhe gjithashtu është krahasuar me shtyllat kryesore, siç janë: dëshmia, namazi, zekati, haxhi. Në fjalën e Pejgamberit sal-Allahu alejhi ue sel-lem thuhet: *"Është ndërtuar Islami në pesë shtylla: dëshmia se nuk meriton*

askush të adhurohet me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe shkuarja në haxh për atë që ka mundësi.”²³

3. Në të hapen dyert e xhenetit.
4. Në të mbyllen dyert e xhehenemit.
5. Në të lidhen shejtanët me pranga.

Këtë që u përmend e sqaron hadithi i Pejgamberit sal-
lAllahu alejhi ue sel-lem, të cilin e transmeton Ebu
Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të. “Kur të vijë
Ramazani, hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e
xhehenemit dhe lidhen (pengohen) shejtanët.”²⁴

Ndërsa në transmetimin e Muslimit thuhet: "Hapen
dyert e mëshirës, mbyllen dyert e xhehenemit dhe lidhen
shejtanët."

6. Në të është Nata e Kadrit, që është më e mirë se një
mijë muaj.

Allahu i Madhëruar thotë:

لَيْلَةُ ﴿٢﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا لَيْلَةُ الْقَدْرِ ﴿١﴾ إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ
تَنْزِيلَ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ فِيهَا بِإِذْنِ ﴿٣﴾ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِنْ أَلْفِ شَهْرٍ
سَلَامٌ هِيَ حَتَّى مَطَلَعِ الْفَجْرِ ﴿٤﴾ رَبِّهِمْ مِنْ كُلِّ أَمْرٍ

²³ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

²⁴ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

1. *Ne e kemi zbritur (Kur'anin) në Natën e Kadrit.*
2. *E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është nata e Kadrit?*
3. *Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj.*
4. *Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet.*
5. *Paqe është ajo deri në lindjen e agimit*

Muxhahidi ka thënë: “Veprat, agjërimi, namazi i natës në të është më i mirë se një mijë muaj). Ibadeti në këtë natë është më i vlefshëm se 83 vite e 4 muaj.”

Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep atij që do, Ai është i Zoti i dhuntisë së përsosur.

Muxhahdi gjithashtu ka thënë: “Ka qenë një njeri nga beni israilët, i cili falte namaz natën deri në agim, pastaj luftonte kundër armikut deri në mbrëmje. Kishte vepruar kështu një mijë muaj. U la përshtypje muslimanëve vepra e tij dhe pastaj e zbriti Allahu këtë ajet.

Nga Enes bin Maliku, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmetohet se kishte hyrë muaji i Ramazanit dhe Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem kishte thënë: “Me të vërtetë ky muaj ju ka ardhur, në të është një natë më e mirë se një mijë muaj...”

7. *Arritja e faljes së mëkateve për atë që ka agjëruar me besim të plotë duke shpresuar shpërblim nga Allahu i Madhëruar.*

8. *Arritja e faljes së mëkateve për atë që është falur me besim të plotë duke shpresuar shpërblim nga Allahu i Madhëruar.*

9. *Arritja e faljes së mëkateve për atë që falet Natën e Kadrit me besim të plotë duke shpresuar shpërblim nga Allahu i Lartësuar.*

Këto veçori të lartpërmendura i argumenton hadithi që transmeton Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *"Kush ngrihet për t'u falur Natën e Kadrit me besim të plotë duke shpresuar shpërblim tek Allahu i Lartësuar, falen mëkatet e mëparshme. Kush e agjëron Ramazanin me besim të plotë duke shpresuar shpërblim tek Allahu azeuexhel, i falen mëkatet e mëparshme."*

10. *Shpëtimi nga ndëshkimi i zjarrit të xhehenemit në këtë muaj.*

Nga Ebu Umamja, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmetohet se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *"Allahu i Lartësuar për çdo iftar amniston nga zjarri."*

11. *Për çdo musliman në çdo ditë të Ramazanit ka lutje të pranuar.*

Seid el Hudrij, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: *"I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "Allahu shpëton nga dënimi i zjarrit në çdo ditë"*

dhe natë të Ramazanit. Me të vërtetë për çdo musliman në çdo ditë dhe natë ka lutje të pranueshme.”

Dijetari Salih el Fevzan ka thënë: “Prej mirësive të agjërimit është se duaaja e agjëruesit është e pranueshme. Ka ardhur nga Ibn Maxhja dhe Hakimi nga Ibn Omeri, se i Dërguari i Allahut sal-Allahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Me të vërtetë për agjëruesin, kur të bëjë iftar, duaaja e tij nuk kthehet mbrapa (i pranohet).”*

Për këtë arsye Allahu i Lartësuar ka thënë gjatë ajeteve të agjërimit:

أَجِيبُ دَعْوَةَ الدَّاعِ إِذَا وَ إِذَا سَأَلَكَ عِبَادِي عَنِّي فَإِنِّي قَرِيبٌ
دَعَانِ فَلْيَسْتَجِيبُوا لِي وَلْيُؤْمِنُوا بِي لَعَلَّهُمْ يَرْشُدُونَ

“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thua ju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.”²⁵

I dashur vëlla, shpreshtoji lutjet e tua!

²⁵ Bekare, 186

6. HISTORIKU I AGJËRIMIT²⁶

Agjërimi është një adhurim i vjetër, i cili ishte i pranishëm edhe tek popujt para nesh dhe bartej nga një popull te tjetri edhe pse ata nuk pajtoheshin për mënyrën e njëjtë. Allahu thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

*'O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.'*²⁷

Allahu ua kishte bërë obligim agjërimitin hebrenjve dhe ky agjërimit është në ditën e dhjetë në muajin e shtatë, që quhet Tisrij. Agjërimit fillon pas perëndimit të diellit në ditën e nëntë deri në perëndim të ditës së dhjetë, që njihet si shpagimi i gabimeve, që e quajnë Kevur, pastaj rabinët e tyre i shtuan edhe katër ditë të tjera, që janë dita e parë e muajit të katërt, pesë, shtatë dhe dhjetë si përkujtim për mbrojtjen e Bejtul Makdisit.

Ata kanë edhe agjërimit vullnetar. Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka thënë: "Agjërimit më i dashur tek Allahut është agjërimit i Davudit a.s.

²⁶ <http://islamweb.net/>, përshtati në gjuhën shqipe Rashit Zylfiu.

²⁷ Kur'an, Bekare: 183.

dhe namazi më i dashur është namazi i Davudit a.s. Ai flinte gjysmën e natës dhe falej një të tretën e saj dhe flinte një të gjashtën e saj. Ai agjëronte një ditë dhe një ditë hante²⁸.

Agjërimi i ditës së ashuras në “Sahih”

Ibn Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmeton se Pejgamberi i Allahut kur erdhi në Medinë, hebrenjtë agjëronin ditën e ashures dhe thanë: “Kjo është dita kur Musaia.s. fitoi kundër Faraonit. Pejgamberi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, u tha shokëve të tij: *‘Ju keni të drejtë më shumë ndaj Musaita.s. se ata (hebrenjtë). Agjëroni!’*²⁵”

Të krishterët i pasonin hebrenjtë në agjërim. Transmetohet nga Ismajilibn Umeje që ka dëgjuar Eba Gutafan bin Trejf elMerijtë thoshte: “Kam dëgjuar Abdullah ibn Abasin, Allahu qoftë i kënaqur me ata të dy, se ka thënë: “Kur Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ka agjëruar ditën e ashuras dhe ka urdhëruar për agjërimin e saj, i thanë: “O i Dërguari i Allahut! Ajo është dita që e madhërojnë hebrenjtë dhe të krishterët.” Në transmetimin e Ebu Davudit thuhet: *“E agjërojnë hebrenjtë dhe të krishterët.”* Pejgamberi alejhi selam tha: *“Viiin tjetër*

²⁸ Mutefekun alejhi.

²⁹ Shënon Buhariu.

(nëse do Allahu) do të agjërojmë ditën e nëntë.” Por vitin tjetër i Dërguari i Allahut vdiq³⁰.”

Më pas priftërinjtë e tyre legjitimuan dyzet ditë agjërim si pasim i Isait a.s., sepse ai kishte agjëruar dyzet ditë para se t’i vinte shpallja. Tek të krishterët lejohet agjërimi i zotimit në rast pendimi apo për arsye të tjera, por ata kanë mënyra të ndryshme të agjërimit. Ata e privojnë veten nga ushqimet e forta apo pijet apo ngrënia një herë në ditë e ushqimit, por u lejohet të ushqehen me një vakt të lehtë.

Disa autorë të tefsirit si Taberiu dhe Ibn Arabiu kanë përmendur se të krishterëve u është bërë obligim agjërimi që të mos hanë pas gjumit dhe të mos kenë raporte intime me gratë e tyre gjatë muajit të agjërimit, ndërsa ata nuk ranë në ujdi për kohën e agjërimit, që mos t’u bjerë në ditët e nxehta të gjata e as në ditë të ftohta e të shkurtra apo zgjodhën që agjërimi të jetë mes verës dhe dimrit e për këtë ndryshim që bënë thanë se do ti kompensojnë dhjetë ditë si shpagim dhe bënë që agjërimi i tyre të jetë pesëdhjetë ditë.

Në kohën para Islamit kishte agjërim siç agjëronin Kurejshët për ashuran në hadithin e Aishes, Allahu qoftë e kënaqur ndaj saj, e cila thotë: “Dita e ashuras ishte dita që agjërohej nga Kurejshët në kohën e

³⁰ Shënon Muslimi.

inJORANCËS. PeJgamberi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, agjëronte në kohën e inJORANCËS. Kur ai erdhi në Medinë, e agjëroi atë ditë dhe urdhëroi që të agjërojnë. Kur u bë obligim agjërimi, ai e la ashuran dhe kush donte, e agjëronte dhe kush donte, e linte³¹.”
*‘...ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.’*³²

Pra, Kur’ani famëlartë na rrëfen se historiku i agjëritit është i lashtë.

³¹ Shënuan Ahmedi dhe Ebu Davudi, e ka saktësuar Albani.

³² Kur’an, Bekare: 183.

7. DISPOZITAT E AGJËRIMIT

- Kuptimi i agjërimit

Në aspektin gjuhësor si jam d.t.th. imsak-përmbajtje, kurse në aspektin terminologjik të adhuruarit e Allahut duke privuar veten (abstenuar) nga ushqimi dhe pijet nga agimi deri në perëndimin e diellit.

- Obligueshmëria e agjërimit

Agjërimi është obligim për muslimanët me Kur'an, Sunet dhe konsensus të umetit.

Allahu thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ
لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

*"O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat."*³³

Pejgamberi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla... agjërimi i Ramazani"*³⁴.

Shtyllat e agjërimit janë: musliman, i rritur në moshë, i mençur, i aftë për agjërime.

³³ Kur'an, Bekare: 183.

³⁴ Shënon Buhariu.

- Nijeti për agjërimin

Nijeti për agjërimin obligativ duhet të jetë para agimit. Nëse bëhet pas agimit, agjërimi nuk vlen. Kjo mbështetet në hadithin e Pejgamberit sal-Allahuejzi i sallam, të cilin e transmeton Ibn Omeri: *‘Nuk agjëron vetëm se ai që ka bërë nijet para agimit’*. *Për dallim nga agjërimi vullnetar, ku mund të bëhet nijeti edhe pas agimit.*³⁵

- A mjafton që në Ramazan të bëhet një herë nijeti apo duhet të bëhet çdo natë?

Nijeti në fillim të Ramazanit mjafton për gjithë Ramazanin, përveç arsyeve kur agjëruesi e ka ndërprerë agjërimin dhe nëse vazhdon, i duhet nijeti rishtazi për ta vazhduar agjërimin.

- A mund të bazohemi që iftarin ta bëjmë me disa ezane që transmetohen përmes televizioneve apo radiove?

Nëse këto televizione apo radio janë të besueshme, atëherë lejohet që të bazohemi në to.

- Me çfarë hyn muaji i Ramazanit?

- a) Me plotësimin e muajit Shaban 30 ditë.
- b) Me shikimin e hënës së muajit Ramazan.

³⁵ Shënojnë Maliku dhe Nesai.

- Kush lirohet nga agjërimi?

Janë disa kategori që lejohen të mos agjërojnë, që u lejohet të mos mbajnë agjërime.

- a) I sëmuri që agjërime ia dëmton shëndetin.
- b) Udhëtari.
- c) Gratë në periudhën e ciklit menstrual dhe periudhën e lehonisë.
- d) Gratë shtatzëna dhe gjdhënësja.
- e) Pleqtë dhe të sëmurët që nuk kanë shpresa për shërim.

Për të gjitha pikat e lartpërmendura ka argument nga Kur'ani dhe Suneti profetik.

- Mënyra e shpagimit për ata që nuk mund të agjërojnë?

- a) Të përgatisë ushqim për të varfrit.
- b) Të shpërndajë ushqimin qoftë i përgatitur apo jo.

- Syfyri

Të ngrenët syfyr në pjesën e fundit të natës është e pëlqyeshme. Pejgamberi, paqja dhe begatitë e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Hani syfyr sepse në të ka begati.”*

- Si është sunet të bëjmë iftar?

Në iftar është sunet të fillojmë me hurma ose me ujë, nëse nuk kemi hurma.

Gjërat që e prishin agjërimin janë:

- a) Pija dhe ushqimi me qëllim, jo me harresë.
- b) Çdo gjë që e zëvendëson ushqimin dhe pijen, si injeksionet ushqyese.
- c) Marrëdhëniet intime.
- d) Cikli menstrual dhe lehonja.
- e) Vjellja me qëllim, edhe nëse është sasi e vogël
- f) Pastrimi i veshkave (dializat).
- g) Injeksionet ushqyese.
- h) Marrja dhe dhënia e gjakut.
- i) Dezertimi nga feja (ridetu).

Nga gjërat e lartpërmendura që e prishin agjërimin besimtari duhet t'i kompensojë me agjërim ditët e lëshuara (mjafton vetëm kompensimi), përveç rastit të marrëdhënieve intime, pasi pason shpagimi (kefareti) duke liruar një rob ose duke agjëruar 60 ditë pandërprerë ose duke ushqyer 60 të varfër. Nuk mund të kalosh nga një hap në tjetrin vetëm në atë rast kur nuk ke mundësi.

- Këshilla për agjërimin
 - a) Ngritja në syfyr dhe vonimi i tij.
 - b) Shpejtimi i iftarit.
 - c) Bërja dua para iftarit dhe gjatë agjërimit.
 - d) Largimi nga fjalët e panevojshme.
 - e) Bujaria dhe kalimi i kohës duke lexuar Kur'an.
 - f) Mësimi i fëmijëve me agjërim.
 - g) Bërja e iftarit me hurma.

- h) Falja e namazit të teravive.
- i) Itikafi në dhjetë netët e fundit të Ramazanit.
- j) Bërja e umres në Ramazan.
- k) Agjërimi i gjashtë ditëve të Shevalit pas Ramazanit.

8. DOBITË E PËRGJITHSHME TË AGJËRIMIT

Prej dobive të përgjithshme të agjërimit janë:

1. Shpërblimi i agjërimit pa kufij.
2. Gëzimi i agjëruesit kur vjen iftari dhe kur takohet me Zotin e tij.
3. Era e gojës së agjëruesit është më e këndshme sesa aroma e miskut (parfumit). Këtë e vërteton hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të. Allahu azeuexhel ka thënë: *“Çdo vepër e birit të Ademit është për të, e mira me dhjetë sevape deri në shtatëqind.”*

Allahu i Lartësuar gjithashtu thotë: *“Përveç agjërimit, ai është për Mua dhe Unë e shpërblej për të; e lë (njeriu) epshin dhe ushqimin e pijen e tij për Mua. Për agjëruesin janë dy gëzime: kur të bëjë iftar, gëzohet për iftarin e tij dhe kur të takohet me Zotin, gëzohet për agjërimitin e tij. Era e gojës së agjëruesit është më e këndshme tek Allahu sesa aroma e miskut (parfumit).”* (Buhariu, Muslimi) Transmetimi i Imam Muslimit tregon për shpërblimin e agjërimit pa kufij. *“Çdo vepër e birit të Ademit shumëfishohet, e mira me dhjetë të mira (sevape) e deri në shtatëqind shumëfishime.”*

Allahu i Madhëruar ka thënë: *“Përveç agjërimit, ai është për Mua dhe Unë e shpërblej për të. E lë (njeriu) epshin dhe ushqimin për mua.”*

4. Për agjëruesit është një derë në xhenet, në të cilën nuk hyn askush përveç tyre.

Sehl ibn Sa'di, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmeton nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se ka thënë: *"Me të vërtetë në xhenet është një derë, i thuhet Rejan, hyjnë nga ajo agjëruesit Ditën e Kiametit, nuk hyn në të askush përveç tyre. Sapo të hyjnë, mbyllet (dera) dhe nuk hyn në të më askush."*³⁶

Në transmetimin e Termidhiut: *"Dhe kush hyn në të (derën Rejan), nuk do të ketë etje kurrë."*

5. Agjërimi është mburojë prej zjarrit të xhehenemit. Dijetari Salih el Fevzan ka thënë: "Prej dobive të agjërimit është se e pastron pronarin prej mëkateve, e ruan nga ephset e dëmshme dhe nga dënimi i zjarrit. Ka ardhur në transmetime të sakta se agjërimi është "xhune", që do të thotë mburojë (perde) nga këto rreziqe."

6. Agjërimi është derë prej dyerve të mirësive.

Muadh bin Xhebeli, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmeton se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ka thënë: *"A dëshiron të të tregoj dyert e mirësive?"* Thashë: "Po, i Dërguar i Allahut!" Tha: *"Agjërimi është mburojë (perde), sadakaja (lëmosha) i ardon mëkatet siç e shuan uji zjarrin."*

7. Agjërimi ndërmjetëson për agjëruesin në Ditën e Gjykimit.

³⁶ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

Abdullah bin Amri, Allahu qoftë i kënaqur me të dy, transmeton se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Agjërimi dhe Kur’ani ndërmjetësojnë për njeriun Ditën e Gjykimit. Agjërimi thotë: “O Zoti im, e ka lënë ushqimin dhe epshin, më bëj që të ndërmjetësoj për të (agjëruesin).” Kur’ani thotë: “O Zoti im, e ka lënë gjumin natën, më bëj që të ndërmjetësoj për të (lexuesin e Kur’anit).”* Ka thënë: *“Ndërmjetësoni (ju të dy) për të (njeriun).”*

8. Agjërimi nuk krahasohet me asgjë.

Kumtohet nga Ebu Umamja, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ka thënë: *“Shkova tek i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe i thashë: “O i Dërguari i Allahut, më trego një vepër që më bën dobi tek Allahu i Lartësuar: ‘Agjëro, se agjërimi nuk krahasohet me asgjë.’”*

9. Agjërimi është derë që të çon drejt devotshmërisë. Allahu i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا كُتِبَ عَلَيْكُمُ الصِّيَامُ كَمَا كُتِبَ عَلَى الَّذِينَ مِن قَبْلِكُمْ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

‘O besimtarë! Ju është urdhëruar agjërimi, ashtu si u ishte urdhëruar atyre para jush, që të mund të ruheni nga të këqijat.’³⁷

10. Sa më shumë ta shtojë njeriu agjërimin, aq më shumë e largon Allahu zjarrin e xhehenemit prej tij.

³⁷ Kur’an, Bekare: 183.

Nga Ebu Seidi, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmetohet se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Nuk ka njeri që agjëron një ditë për hir të Allahut e që të mos ia largojë Allahu i Lartësuar fytyrën nga zjarri i xhehenemit për shtatëdhjetë vite.”*³⁸ Kjo është për ata që agjërojnë një ditë, por si është puna e atij që agjëron një ditë po e një ditë jo, çdo të hënë dhe të enjte ose tri ditë në çdo muaj?!

O ju robër të Allahut!

Me të vërtetë ky muaj është rast që nuk zëvendësohet; punoni për të, Allahu ju mëshiroftë, duke bërë vepra të mira. Bëni përpjekje në ibadete, shfrytëzoni kohën, e cila ju afron tek Zoti juaj, me namaz, agjërim, sadaka, lexim të Kur’anit, përmendje (dhikër), dua, urdhëroni për të mirë e ndaloni nga e keqja.

Kini kujdes, Allahu ju mëshiroftë, nga gjithë ajo që e hidhëron Allahun azeuexhel, mos e prishni agjërimin tuaj me vepra që janë në kundërshtim me fenë e Allahut, se i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Ai që nuk i shmanget gënjeshtërisë dhe punës me të dhe amoralitetit, Allahu nuk ka nevojë që ai (njeriu) ta lërë ushqimin dhe pijen.”* Ka humbur ai i cili ka dalë nga ky muaj duarbosh. Përkujtoni, Allahu ju mëshiroftë, ata të cilët kanë agjëruar me ne vitin e kaluar, por nuk u është mundësuar të agjërojnë këtë

³⁸ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

vit ose për shkak se janë shndërruar në trupa të palëvizshëm në varre ose sepse janë goditur nga sëmundje prej të cilave nuk mund të agjërojnë. Ata shpresojnë të agjërojnë me ne qoftë edhe vetëm një ditë.

Përkujtoni këto momente dhe dijeni se vdekja vjen papritmas; ajo merr foshnjat, fëmijët, të rriturit dhe plakun, prandaj mos t'ju mashtrojë shëndeti dhe forca rinore.

Një poet thotë:

Sa prej të shëndoshëve pa ndonjë sëmundje vdiqën,

E sa prej të sëmurëve kohë të gjatë jetuan.

E lus Allahun e Madhëruar që të na bëjë prej të shpëtuarve në këtë muaj të begatshëm!³⁹

³⁹ Përgatiti Daruel Vatan, përktheu Rashit Zylfiu.

9. KATEGORITË E NJERËZVE NË RAMAZAN

Ebu Vakid el-Lejthi thotë: "Gjersa i Dërguari i Allahut ishte ulur në xhami dhe njerëzit ishin përreth tij, erdhën tre persona. Dy u afruan afër Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe njëri shkoi. Njëri prej tyre pa një zbrazësi në mexhlis dhe u ul, tjetri u ul mbrapa tyre, ndërsa i fundit ua ktheu shpinën dhe shkoi. Kur Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e përfundoi mexhlisin, tha: "A doni t'ju tregoj për këta tre persona? Njëri nga ata u afrua tek Allahu (e meritoi shpërblimin e Allahut), tjetrit i erdh turp dhe u turpërua Allahu nga ai (Allahu e mëshiroi), ndërsa i fundit ktheu shpinën, la mexhlisin, Allahu e la atë (Allahu u hidhërua me të)." ⁴⁰

Në këtë hadith Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i ndan njerëzit në tre grupe në raport me vendet ku merret dituria.

1. I interesuar dhe që bën përpjekje për të arritur tek pika më e afërt pranë Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, i cili përfaqëson diturinë në këtë rast.
2. Atij që i vjen turp nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe nga muslimanët.
3. Ai i cili ua kthen shpinën vendeve ku merret dituria, vendeve ku përmendet Allahu. Kujdesi dhe mëshira e

⁴⁰ Shënon Buhariu.

Allahut nuk është mbi të ashtu siç ai nuk tregoi interes për veten e tij.

Nëse Ramazani është mësim nga mësimet e fesë, një medrese ku besimtarët përfitojnë, njerëzit karshi tij ndahen në tri kategori:

Kategoria e parë: Kategori që kthehen tek Allahu në Ramazan. Agjërojnë ditën dhe falen natën. Kryejnë obligimet dhe e ndalin veten nga ajo që Allahu ka ndaluar. Ia japin besën Allahut se do të pendohen, do të kërkojnë falje për gabimet e bëra dhe nuk do të kthehen më në to.

Kategoria e dytë: Ramazani ndikon që t'u vijë turp nga Allahu dhe nga njerëzit. Kjo kategori agjëron, por nuk është këmbëngulëse që të pendohet dhe të kthehet tek Allahu. Janë të luhatur mes pendimit dhe vazhdimësisë në jetën që kanë bërë para Ramazanit.

وَأَخْرُونَ اعْتَرَفُوا بِذُنُوبِهِمْ خَلَطُوا عَمَلًا صَالِحًا وَآخَرَ سَيِّئًا عَسَىٰ
إِنَّ اللَّهَ عَفُورٌ رَّحِيمٌ اللَّهُ أَنْ يَتُوبَ عَلَيْهِمْ

“Ndërkaq, disa të tjerë i pranojnë gjynahet e veta, se i kanë përzier veprat e mira me të këqijat. Ka gjasë që Allahu t’ua pranojë pendimin. Vërtet, Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë.”⁴¹

⁴¹ Kur’an, Teube: 102.

Kjo kategori ka nevojë të jenë më të përqendruar dhe t'i kushtojnë rëndësi më shumë fesë së tyre që të bëhen si kategoria e parë.

Kategoria e tretë: Ramazani për këtë kategori nuk është interesant, ai vjen dhe shkon por tek ata nuk lë gjurmë për të lëvizur një hap para. Dëgjojnë ezanin, dëgjojnë fjalët e Allahut, por gjithmonë ua kthejnë shpinën. Kjo kategori është e rrezikuar dhe më e rrezikshmja në shoqëri.

Këto janë tri kategori karshi Ramazanit dhe karshi çdo mësimi në këtë jetë.

Është pyetur Abdullah ibn Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur ndaj tij: "Si e pritnit ju Ramazanin në kohën e Pejgamberit sal-Allahu alejhi ue sel-lem?" Ai u përgjigj: *"Vinte Ramazani dhe në zemrat tona nuk gjente urrejtje ndaj askujt."*

10. 10 HAPA SI TË PËRFITOJMË NGA RAMAZANI

Muslimani e di qëllimin e ardhjes në këtë botë dhe detyrën që është i obliguar ta kryejë, e cila është adhurimi. Ne çdo vit e presim Ramazanin dhe e përcjellim atë, por a kemi mësuar vallë atë që kanë mësuar nga Ramazani gjeneratat e para të këtij umeti?

Transmetohet se të parët tanë gjashtë muaj e kanë lutur Allahun t'ua pranojë Ramazanin dhe gjashtë muaj të tjerë që t'ua mundësojë prapë atë.

Ramazani është një shkollë, një institucion besimi, edukate, morali dhe ekonomie. Është një adhurim që përfshin zemrën, trupin dhe pasurinë.

Cilët janë hapat që ne të përfitojmë nga Ramazani?

1. Ramazani, shkollë e sinqeritetit

Njëra ndër gjërat me të cilat muslimani dallohet në këtë jetë është sinqeriteti i tij, pra punët i bën për Krijuesin e tij e jo për dikë tjetër. Sinqeriteti është faktori kryesor për ta ditur besimtari nëse e ka veprën të pranuar apo jo, thënë më ndryshe kusht për të na u pranuar veprat është sinqeriteti.

2. Ramazani, shkollë e durimit

Agjërimi na mëson se duhet të jemi të durueshëm në jetë përballë sfidave me të cilat ballafaqohemi.

Agjërimi përfshin të gjitha llojet e durimit, që janë durimi ndaj obligimeve hyjnore, durimi ndaj mëkateve dhe durimi ndaj caktimeve të Allahut.

3. Ramazani, shkollë e devotshmërisë

Agjëruesi, i cili gjatë ditëve të Ramazanit e privon veten nga gjërat e lejuara, ka mundësi ta privojë edhe jashtë Ramazanit nga gjërat e ndaluara.

4. Ramazani, shkollë e ambicieve, vullnetit dhe qëndrueshmërisë

Agjërimi me kalimin e ditëve e edukon besimtarin që të ketë ambicie për të punuar në jetë, i dhuron vullnet të cilin gjatë muajve të tjerë duhet ta shfrytëzojë në atë që është e dobishme.

5. Ramazani, shkollë e fitoreve

Besimtari gjatë muajit Ramazan mat fuqinë e tij të brendshme dhe atë fizike, mat forcën kundër armiqve të tij, kundër nefsit, veseve të këqija dhe djallit.

6. Ramazani, shkollë e menaxhimit të kohës

Njëra ndër gjërat më të shtrenjta për njeriun në këtë jetë është koha e tij. Allahu për shkak të vlerës që ka koha është betuar në Kur'an për kohën me fjalët: "Uelasër-Pasha kohën". Ramazani nëpërmjet programit të tij strikt e mëson besimtarin se si duhet të bëhet menaxhimi i kohës në jetë. A nuk janë në minuta të

caktuara iftari, syfyri, namazi i teravive dhe shumë aktivitete të tjera? Besimtari mundohet ta menaxhojë kohën e tij në Ramazan për të përfituar më shumë nga begatitë e tij.

7. Ramazani, shkollë edukative

Agjërimi në agjendën e tij ka paraparë edhe segmentin edukativ, i cili na mëson se agjërimi ynë nuk duhet të jetë i zhveshur nga etika. Ramazani na mëson se bashkë me barkun duhet të agjërojnë të gjitha pjesët e trupit tonë, larg fjalëve të kota, fyerjeve, nënçmimit, kacafytjes etj.

8. Ramazani, shkollë që na mundëson hyrjen në xhenet

Imam Buhariu transmeton se “xheneti ka tetë dyer dhe një derë quhet Rejan. Nuk hyjnë nga ajo pos agjëruetit.”⁴²

9. Ramazani, shkollë e bamirësisë

Ramazani është një shans i madh për besimtarin që të stërvitet për të qenë human e solidar me të tjerët. Shëmbëlltërit e tij është vetë i Dërguari i Allahut, i cili çdo herë ka qenë bujar, por në Ramazan ka qenë më bujari.

⁴² Shënon Buhariu, 3257.

10. Ramazani, shkollë e mbrojtjes nga zjarri

Dy rrugë të cilat e shpien njeriun në zjarr janë epshi dhe dyshimet. Mundësia që na jep Ramazani është se na ndalon nga epshet dhe dyshimet, kështu që kur njeriu largohet nga këta dy faktorë, atëherë është larguar nga zjarri. Ramazani të jep mundësinë e vendosjes së mburojës ndaj zjarrit sepse vetë Ramazani është mburojë nga dënimi i Allahut.

11. EDUKATA ME RAMAZANIN

Ibn Kajimi thotë: “Edukata është feja”.

Edukata me Allahun

Edukata me Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem

Edukata me krijesat.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

“Kush beson në Allahun dhe Ditën e Gjykimit, le të respektojë mysafirin.”

Nëse ky respekt kërkohet për mysafirët njerëz, si është çështja kur bëhet fjalë për mysafirin që dërgon Allahu çdo vit në shtëpitë e myslimanëve?

Me hënën e re të Ramazanit jepet sinjali se Ramazani ka ardhur, por le të shohim se si po e respektojmë ne këtë mysafir.

Gëzimi në Ramazan

Transmetohet se të parët tanë gjashtë muaj e kanë lutur Allahun t'ua pranojë Ramazanin dhe gjashtë muaj të tjerë që t'ua mundësojë ta përjetojnë prapë atë.

Ebu Hurjera transmeton se Profeti alejhi selam ka thënë: *“Kur vjen muaji i Ramazanit, hapen portat e xhenetit, mbyllen portat e xhehenemit dhe shejtanët prangosen.”*⁴³

⁴³ Transmetojnë Imam Buhariu dhe Imam Muslimi.

Respektimi i mysafirit

Me mysafirin e Allahut kërkohet ruajtja e gjuhës dhe sjellja e mirë, nuk duhen përdorur shprehje të këqija me mysafirin.

Muhamedi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë: "*Kush nuk i lë fjalët e rrejshme dhe punën me të, Allahu nuk ka nevojë që ai ta lërë ushqimin dhe pijen.*"⁴⁴

Dhe në hadithin tjetër: "*Shumë agjërues nuk kanë dobi nga agjërimi i tyre pos urisë.*"⁴⁵

Mos e trazo agjërimin tënd

Mysafiri nuk duhet të shohë se ti po sillesh keq me të tjerët. Ai nuk ka dëshirë që ti të jesh nervoz, por ka dëshirë që të jesh fytyrëçelur, i buzëqeshur.

"*E nëse dikush të ngacmon apo sillet ashpër me ty, thuaji: Unë po agjëroj, unë po agjëroj!*"⁴⁶

Kujdesu për mysafirin që të mos digjet

Hafsa bint Sirijn, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Kur shokët e Pejgamberit agjëronin, qëndronin në xhami dhe thoshin se agjërimi është mburojë derisa të mos digjet. E djegia e saj është përgojimi."

⁴⁴ "Xhamiulumuehikem", Ibn Rexhep el Hanbelij, fq. 4001.

⁴⁵ "Sahihut-targibi vet-tarhibi", Shejh Albani.

⁴⁶ "Sahihut-targibi vet-tarhibi", Shejh Albani.

Shfrytëzimi i kohës me mysafirin

Seid el Hudrij, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: "I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ka thënë: *"Allahu shpëton nga dënimi i zjarrit në çdo ditë dhe natë të Ramazanit. Me të vërtetë për çdo musliman në çdo ditë dhe natë ka lutje të pranueshme."*

Agjërimi është mysafir që nuk rri shumë

Allahu thotë:

أَيَّامًا مَّعْدُودَاتٍ

*"Agjërimi zgjat disa ditë"*⁴⁷

Çfarë kërkon mysafiri nga ne:

- Shtimin e adhurimeve
- Leximin e Kur'anit
- Duatë
- Namazet ditore, teravitë
- Sadakanë.

Është pyetur Abdullah ibn Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur me të: "Si e pritnit ju Ramazanin në kohën e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem?" Ai u përgjigj: *"Vinte Ramazani dhe në zemrat tona nuk gjente urrejtje ndaj askujt."*

⁴⁷ Kur'an, Bekare, 184.

12. UNË JAM AGJËRUESHËM!

Allahu deshi që përmes këtij muaji besimtari të bëjë një ndryshim madhështor, që pas Ramazanit të jetë më i mirë seç ka qenë para Ramazanit. Ky objektiv mund të realizohet vetëm atëherë kur Ramazani depërton në zemrën tonë dhe e çliron atë që të jetë më e butë karshi adhurimit dhe më e devotshme ndaj Allahut xheleueala.

Ramazani e ndihmon njeriun të pastrohet nga disa vese, edhe pse ato janë të lindura ose janë pjesë e natyrshmërisë njerëzore.

Pejgamberi alejhi selam ka thënë: *“Agjërimi është mbrojtje nga zjarri i xhehnemit. Kushdo që gdhihet agjërueshëm, atë ditë të mos sillet keq, e nëse ndonjëri sillet ndaj tij me keq, mos ta ofendojë e as mos ta fyejë, por le të thotë: “unë jam agjërueshëm, unë jam agjërueshëm”*

Në këtë hadith hasim mrekulli shkencore. Kush hidhërohet në Ramazan përveçse hidhëron Allahun, dëmton shëndetin e tij psikik dhe fizik si dhe humb shumë sepse humb sevapin e agjëritimit.

Në rast se njeriu hidhërohet, adrenalina e tij rritet dhjetë herë më shumë. Adrenalina në këtë moment shkakton çrregullime në trupin e njeriut, për shembull ai ndien lodhje sepse harxhon shpejt oksigjenin duke u djersitur. Ai urinon më shpejt dhe kështu harxhon lëngjet që ka në trup dhe ndien lodhje të madhe gjatë agjëritimit.

Sipas një studimi, është zbuluar se nga 1305 burra të intervistuar për shtatë vite me radhë, të cilët i përkasin tipit emocional dhe hidhërohen shpesh, përqindja më e madhe e tyre kanë dhembje dhe shtrëngim në gjoks. Studiuesit tregojnë se ilaçi më i mirë i hidhërimit është falja, durimi.

Studimet e ndryshme në këtë drejtim tregojnë se trajnimet e vazhdueshme mund të sjellin rezultate që njeriu ta kontrollojë hidhërimin.

Në kulturën tonë islame kemi shumë këshilla fetare të cilat na mësojnë si mund ta kontrollojmë hidhërimin. Përveç kësaj, nëse njeriu arrin ta fshehë mllëfin e tij, kjo llogaritet si shkalla më e lartë e imanit.

Allahu thotë:

وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ وَالْكَاطِمِينَ الْغَيْظَ وَالْعَافِينَ عَنِ النَّاسِ

‘Të cilët japin lëmoshë, edhe kur kanë edhe kur janë në skamje, të cilët e mposhtin hidhërimin dhe i falin njerëzit. Edhe Allahu i do punëmirët.’⁴⁸

Një ndër qëllimet e agjërimit është ushtrimi praktik se si njeriu ta kontrollojë hidhërimin e tij, sepse nëse nuk arrin, ai shumë shpejt do të jetë nga ata që lodhen fizikisht, psikikisht e shpirtërisht dhe në të njëjtën kohë ka humbur sevapin e agjërimit.

⁴⁸ Kur’an, Al’imran: 134.

Kush e ka këtë ves të keq dhe nuk ka arritur të ndryshojë në Ramazan, le të pyesë veten: Pse nuk ndryshova në Ramazan? Pse Ramazani nuk arriti të më ndryshojë? A agjërova unë apo jo? Sepse Ramazani nuk erdhi vetëm për Ramazanin, por edhe për pas Ramazanit.

13. E JU, A DO TË NDRYSHONI?!

Secili prej nesh në këtë jetë është në kërkim të ndryshimit, të një jete më të mirë, komoditetit, shtëpisë, veshjeve, ushqimit e të tjera. Por e mira e muajit Ramazan është se ai është vetë ndryshimi. Kur vjen ky muaj, gjithçka duket më ndryshe.

I Dërguari i Allahut thotë: *"Kur të vijë Ramazani, hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e xhehenemit dhe lidhen shejtanët."*⁴⁹

Ndryshimi gjatë udhëtimit të tij viziton çdo shtëpi besimtarësh, të cilët i bëjnë konak mysafirrit të Allahut. Me ardhjen e hënës së re çdo zemër besimtari rreh më ndryshe, me energji të re, me zell të pakrahasueshëm për të ecur rrugës drejt xhenetit.

Ndryshimi që sjell muaji Ramazan fillon nga raportet me Allahun. Besimtarët dhe besimtare të sheh më afër Allahut, më të përkushtuar në adhurime, më të përlulur, u përgjigjen më shpejt urdhrave të Allahut.

Pastaj besimtari vazhdon me vetveten, duke u munduar t'i përmirësojë gabimet, duke kaluar nga veset e liga tek veprat e mira, nga gënjeshtria në sinqeritet.

Ndryshimi nuk harron as të tjerët sepse bamirësi duket më bujar, fytyra e jetimit dhe e fukarasë buzëqesh më shumë, kurse zekati dhe lëmosha përfshin nevojtarët.

⁴⁹ Muttefekun alejh.

Vëllezër dhe motra të nderuara!

Në Ramazan bota duket më ndryshe. Për tridhjetë ditë "Medreseja e Ramazanit" është e hapur dhe u jep besimtarëve një trajnim falas, u dhuron energji për të udhëtuar drejt ahiretit, i mëson, i edukon si t'i tejkalojnë sfidat dhe problemet e mundshme me të cilat mund të ballafaqohen.

E ju, a do të ndryshoni?!

14. RAMAZANI DHE JETA

Nëse ndalesh dhe e shikon muajin Ramazan nga një kënd tjetër, do të gjesh vërtet një shembull praktik që ka lidhje dhe përngjasim të madh me jetën tonë, apo thënë më ndryshe është si një jetë e minimizuar. Ajo është panorama e jetës sonë, pasqyrë reflektimi se si duhet ta kuptojmë jetën. Ramazani na jep mësim praktikë se si duket jeta jonë.

Po cilat janë vërtet këto pasqyrime apo skica të jetës që na jep Ramazani?

Ashtu siç lind hëna e re, lind edhe njeriu.

2. Njeriu është udhëtar në jetën e kësaj bote ashtu siç është edhe muaji Ramazan.

3. Jeta ka sfidat e saj ashtu siç ka edhe Ramazani.

4. Njeriu në Ramazan gjendet përballë tre durimeve, të njëjtat që janë edhe në jetën tonë:

- durimi ndaj caktimit të Allahut
- durimi ndaj adhurimeve
- durimi ndaj ndalesave.

5. Ramazani i mëson njeriut moton e shpëtimit në jetë: “Unë jam agjërueshëm”. Ashtu siç e ruajte agjërimin tënd që mos ta dëmtosh, mos ia jep rastin gjithkujt ta dëmtojë jetën tënde.

6. Ashtu si Ramazani kërkon angazhimin maksimal, edhe jeta kërkon nga ne një angazhim të tillë që të jemi të suksesshëm.

7. Ashtu si Ramazani është në ditë të caktuara, edhe jeta jonë i ka ditët të caktuara e të afatizuara.

8. Ramazani na mëson se ashtu siç ishim bujarë në të, të jemi edhe gjatë ditëve të tjera të jetës sonë.

9. Në Ramazan çdo besimtar kërkon faljen e Zotit, kurse në jetë Zoti na këshillon që t'ua falim njerëzve gabimet që bëjnë gjatë jetës.

10. Teksa Ramazani shkon, i shtohet vlera. Po kështu duhet të jetë edhe jeta jonë, sa më shumë të shtyhem në moshë, duhet t'ia dimë vlerën. Hasen el Basriu thotë: “O bir i Ademit, një ditë për ty, një ditë kundër teje.”

Zot, na mundëso që të kemi një jetë të lehtë nga belatë dhe sprovat e saj dhe pranona veprat tona që bëjmë derisa të jemi gjallë, o më i madhi i gjithësisë!

15. KUSH ËSHTË FITUESI NË RAMAZAN?

Ramazani është një garë në të cilën besimtarët garojnë për të fituar shpërblimin e Allahut. Çdo garë ka sfidat e veta, ashtu si edhe shpërblimin që jepet për fituesin. Sfida e kësaj gare është se zgjat 30 ditë, gjatë të cilave kërkohet të japësh maksimumin. Është një garë botërore dhe çdo musliman ka të drejtë të marrë pjesë. Specifikat e garës

- Është botërore
- Pjesëmarrja është e hapur
- Pjesëmarrja në të është e hapur në fillim, në mes, në fund të saj
- Mbahet në ditë të caktuara
- Agjërimi është kusht
- Hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e xhehene-mit, prangosen djajtë.

Kriteret e garës

Çdo njeri që shpreh shehadetin, është në moshën madhore dhe është i shëndetshëm fizikisht dhe psikikisht mund të marrë pjesë.

Shpërblimi i garës

Nuk ka dyshim se shpërblimi i kësaj gare është i madh, është xheneti. Xheneti për të cilën as mendja nuk të ka shkuar, as veshi s'ka dëgjuar, as syri nuk ka shikuar. Por në xhenet nuk shkohet me gjynahe, kërkohet

pastrim gjeneral nga gjynahet. E këtë mundësi ta jep kjo garë që quhet Ramazan. I Dërguari i Allahut na përgëzon duke thënë: *"Ai që agjëron Ramazanin duke i njohur kufijtë e tij dhe duke u ruajtur prej atyre gjërave që duhet të ruhet, arrin faljen e mëkateve që ka bërë më parë."*⁵⁰

Kush është fituesi?

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *"Ai që fal namazin e natës në Natën e Kadrit me besim dhe shpresë për shpërblimin (nga Allahu), i falen të gjitha gjynahet që ka bërë."*⁵¹

Ibn Mesudi thoshte: "Cili prej nesh është i pranuar, që ta përgëzojmë? E cili prej nesh është i privuar, që ta ngushëllojmë? Urime për ty që je pranuar! Ndërsa ti që je privuar, Allahu të ndihmoftë në fatkeqësinë që të ka rënë!" Aishja, Allahu qoftë e kënaqur me të, i tha të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "Çfarë duhet të them nëse e arrij Natën e Kadrit?" Ai tha: *"O Allah! Ti je Falës dhe e do faljen, prandaj më fal!"*⁵²

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë: *"Çdo natë Allahu liron njerëz nga zjarri i xhehenemit."*

Allahu e bën këtë sepse emri i Tij është Falës.

⁵⁰ Shënon Imam Ahmedi, 3/55. Shejh Shuajb Arnauti te "Musnedi" (18/84) thotë: "Senedi i këtij hadithi është i dobët, por hadithi është hasen".

⁵¹ Shënon Buhariu, nr. 1901.

⁵² Shënon Termidhiu, 3513.

16. SI TË NDRYSHOJMË NË RAMAZAN

Ebu Hurjera transmeton se Profeti alejhi selam ka thënë: *“Kur vjen muaji i Ramazanit, hapen portat e xhenetit, mbyllen portat e xhehenemit dhe shejtanët prangosen.”*⁵³

Sikur të ndalemi dhe të meditojmë rreth kësaj, do të gjejmë një energji e cila do të na shpjerë përpara që t'u shmangemi mëkateve dhe të garojmë në vepra të mira. Ramazani është rast i mirë që të ndryshojmë ngase pikërisht në këtë muaj u bë ndryshimi i historisë, u kalua nga errësira në dritë.

A nuk është muaji Ramazan ai në të cilën u shpall Kur'ani?

A nuk është muaji Ramazan ai kur ndryshohen ligjet e Allahut, hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e xhehenemit dhe prangosen djajtë?

A nuk ndodhi në Ramazan lufta e madhe e Bedrit, ku triumfoi ushtria e Muhamedit alejhi selam dhe pas asaj dite ylli i Islamit mori hov?

A nuk ishte çlirimi i Mekës po në këtë muaj, ku njëherë e përgjithmonë Qabeja e bekuar pastrohet nga njollat e shirkut dhe të kufrit?

Të gjitha këto shkaqe na japin të kuptojmë se Ramazani është rasti më i favorshëm për atë që dëshiron të ndryshojë në jetën e tij ngase dyert janë të

⁵³ Transmetojnë Imam Buhariu dhe Imam Muslimi.

hapura dhe nuk kërkohet asgjë përveç vullnetit të sinqertë.

Ramazani është rasti më i mirë për të ndryshuar ngase besimtari bëhet i devotshëm. Allahu i Madhëruar thotë:

لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“...që të mund të ruheni nga të këqijat.”⁵⁴

Dobia madhore e Ramazanit është që të bëhemi të devotshëm.

Shiko se si Aliu radijAllahu anhu e përshkruan devotshmërinë: “Devotshmëria është frika nga Allahu, të punuarit me ligjin e Tij, ngopje me të paktën dhe përgatitje për ditën e fundit.”

Ramazani është rasti për të ndryshuar nëse nuk ke qenë prej atyre që falnin namaz apo e ke vonuar nga koha e tij. Njëherë e përgjithmonë nëse dëshiron të ndryshosh në jetë, e para gjë që duhet të kërkosh nga ky Ramazan është t’i falësh të pesta kohët dhe ta kuptosh se nga një besimtar që ka falur vetëm xhumanë tash e tutje do të falësh pesë kohë dhe do ta kuptosh se kjo do të sjellë ndryshim pozitiv në jetë, pasi namazi është lidhja më e fortë me Zotin.

Ramazani është rast i mirë për atë që ka rënë në bela me drogën, alkoolin, duhanin sepse i jep energjinë për

⁵⁴ Kur’an, Bekare: 183.

t'i braktisur këto dukuri të shëmtuara, të cilat ia shkatërrojnë jetën, familjen dhe shoqërinë.

Njeriu e pyet Ramazanin: -Si të ndryshoj?

Ramazani i përgjigjet: -Ashtu si ke mundësi, pra gjërat që në esencë i ke hallall, lëri tërë ditën dhe do të kesh mundësinë që njëherë e përgjithmonë t'i braktisësh këto bela në të cilat ke rënë, sa nuk është bërë vonë.

Vëlla i dashur!

Unë të përgëzoj se ti mundesh dhe argument për këtë është imani yt në Krijuesin e gjithësisë. Kush të pengon që këto gjëra mos t'i bësh gjatë Ramazanit, kush nga njerëzit e di se ti je duke agjëruar apo jo? Vetëm frika dhe bindja se Allahu e di dhe të shikon të bën të agjërosh.

Ti pate vullnet që të agjërosh 17 orë në ditë, a nuk është momenti që ky vullnet të të ndihmojë të ndryshosh njëherë e përgjithmonë dhe të mos i përdorësh më drogat?

Kërko ndihmën e Allahut që t'i braktisësh këto bela.

Ramazani është rast i mirë për të ndryshuar edhe ai që është zhytur në kamatë dhe borxhe si dhe mundësia më e mirë për të dalë prej kësaj belaje nga e keqja në të mirë.

Ti ke mundësinë që t'i ngresh duart me besimtarët në Ramazan për t'iu lutur Allahut, por nëse rrobat dhe ushqimi yt janë nga harami, atëherë si të të përgjigjet ty Allahu?

Allahu do që ti të ndryshosh e të pendohesh te Zoti. Pendimi është ndryshim ngase ti po braktis gjynahet, po kalon nga një njeri që ishe larg Zotit në një besimtar që po i afrosh Zotit tënd. A nuk është ky ndryshimi më i lumtur në jetën tënde?

Allahu thotë:

إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ التَّوَّابِينَ وَيُحِبُّ الْمُتَطَهِّرِينَ

*“Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen.”*⁵⁵

Mesazhi

Ibn Xhevzij thotë: "Shpirti është si zogu: nëse e tremb me zë, shpeshherë nuk ikën, por nëse sheh se ke gur në dorë, atëherë menjëherë ikën. Edhe shpirti, nëse sheh nga ti vendosmëri, ndalet nga gjërat e këqija që kërkohen nga t'i ti ndryshosh në të mira.

Allahu i Madhëruar thotë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّىٰ يُغَيِّرُوا مَا بِأَنفُسِهِمْ

*“Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç'kanë në vetvete.”*⁵⁶

⁵⁵ Kur'an, Bekare: 222.

⁵⁶ Kur'an, Rad: 11.

17. AMNISTIA HYJNORE NË NATËN E KADRIT

Vëllezër besimtarë!

Është çudi që gjërave në këtë botë sa herë që u vjen fundi, u harxhohen të mirat dhe dobitë, kurse Ramazani është ndryshe sepse sa herë i vjen fundi, i shtohet edhe më shumë vlera dhe begatia.

A nuk kemi hyrë në dhjetëshen e fundit të Ramazanit, në këto net që janë më ndryshe se ato që kaluam për shkak të një nate shumë të veçantë, sekreti i së cilës është falja e Allahut?

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: "*Ai që fal namazin e natës në Natën e Kadrit me besim dhe shpresë për shpërblimin (nga Allahu), i falen të gjitha gjynahet që ka bërë.*" ⁵⁷

Një ditë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem përmendi një njeri nga bijtë e Izraelit, i cili kishte bërë ibadet natën dhe kishte luftuar ditën pandërprerë për tetëdhjetë vite. Të pranishmit u habitën nga kjo ndodhi dhe Allahu zbriti suren Kadër.

لَيْلَةٌ ﴿٢﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا لَيْلَةُ الْقَدْرِ ﴿١﴾ إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ
تَنْزِيلُ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ فِيهَا بِإِذْنِ ﴿٣﴾ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِّنْ أَلْفِ شَهْرٍ
﴿٥﴾ سَلَامٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطْلَعِ الْفَجْرِ ﴿٤﴾ رَبِّهِمْ مِّنْ كُلِّ أَمْرٍ

⁵⁷ ShënonBuhariu, nr. 1901.

1. *Ne e kemi zbritur (Kur'anin) në Natën e Kadrit.*
 2. *E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është Nata e Kadrit?*
 3. *Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj.*
 4. *Engjëjt dhe Shpirti (Xhibrili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet.⁵⁸*
- Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.*

Pse Allahu e solli Natën e Kadrit?

Vëllezër të nderuar!

A nuk jemi ne ajo krijesa gabimtare që gjatë tërë vitit rrotullohemi në mëkate dikush haptazi e dikush fshehurazi, dikush më shumë e dikush më pak, por jemi një krijesë që bëjmë gabime? A nuk jemi ne ata të cilët e ngarkojmë veten me gjynahe dhe e fusim shpirtin tonë në burgun e errët si rezultat i gabimeve tona dhe më pas nuk mund të jetojmë të lumtur dhe në rehati?

Pikërisht për këtë arsye shtrohet nevoja e pastrimit, e liritimit dhe shprangosjes nga ngulfatja e mëkateve dhe gabimeve tona të panumërta. Këtë pastrim Zoti e sjell

⁵⁸ “Nata e Kadrit” do të thotë “Nata e Caktimit”. Në këtë natë, Allahu i Madhëruar ka filluar t’i shpallë Kur’anin Muhamedit (a.s.). Ajo është një nga netët teke të 10-ditëshit të fundit të muajit Ramazan. Gjatë saj engjëjt zbresin me të gjitha vendimet hyjnore për çfarë do të ndodhë në Tokë brenda një viti.

për ne. Begatitë e kësaj nate janë të mëdha, por a jemi të gatshëm t'i shfrytëzojmë?

Të nderuar besimtarë!

Paramendoni sikur jeni në burgjet e kësaj dynjaje, mes mureve të errëta, ku nuk e shihini dritën e diellit me sy, larg familjes dhe shoqërisë, duke mos e gëzuar atë që quhet liri. A nuk do të kishit ëndërruar që t'ju vinte lajmi se jeni futur në listën e të amnistuarve, se për pak ditë do të dilni nga burgu. Sa do të gëzoheshit?

Vallahi vëllezër, burgu në të cilën na fusin mëkatet tona, burgu i shpirtit është më i rëndë se ai i trupit! Shumë njerëz i shohim duke jetuar të lirë, por shpirtat e tyre janë në burgje. A nuk dëshirojmë që Zoti të na fusë në listën e të amnistuarve në këtë natë të bekuar, që të na lirojë njëherë e përgjithmonë nga zjarri i xhehenemit?!

I Dërguari i Allahut alejhi selam na përgëzon duke thënë: *"Ai që agjëron Ramazanin duke i njohur kufijtë e tij dhe duke u ruajtur prej atyre gjërave që duhet të ruhet, arrin faljen e mëkateve që ka bërë më parë."*⁵⁹

Ibn Mesudi thoshte: "Cili prej nesh është i pranuar, që ta përgëzojmë? E cili prej nesh është i privuar, që ta ngushëllojmë? Urime për ty që je pranuar! Ndërsa ti

⁵⁹ Shënon Imam Ahmedi, 3/55. Shejh Shuajb Arnauti te "Musnedi" (18/84) thotë: "Senedi i këtij hadithi është i dobët, por hadithi është hasen".

që je privuar, Allahu të ndihmoftë në fatkeqësinë që të ka rënë!”

Aishja, Allahu qoftë e kënaqur me të, i tha të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "Çfarë duhet të them nëse e arrij Natën e Kadrit?" Ai tha: "*O Allah! Ti je Falës dhe e do faljen, prandaj më fal!*"⁶⁰

“El-Afuë” apo Falës është njëri prej emrave të Allahut dhe ka kuptimin: Ai që fal mëkatet e robërve të Tij dhe shlyen gjurmët e tyre. Allahu e do faljen dhe dëshiron t’i falë robërit e Vet. Po ashtu, Ai dëshiron që robërit e Tij ta falin njëri-tjetrin dhe kur ata e falin njëri-tjetrin, Ai i fal ata. Për Të falja është më e dashur se ndëshkimi.

Allahu i Madhëruar thotë:

إِنِّي لَكُمْ مِّنْهُ نَذِيرٌ مُّبِينٌ فَفِرُّوا إِلَى اللَّهِ

*“Andaj, ikni (prej dënimit) drejt (shpërblimit të) Allahut, se unë vërtet që jam dërguar te ju prej Tij, si paralajmërues i qartë!”*⁶¹

Allahu i Lartësuar gjithashtu thotë:

⁶⁰ Shënon Termidhiu, 3513.

⁶¹ Kur’an, Dharijat: 50.

وَسَارِعُوا إِلَىٰ مَغْفِرَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ وَجَنَّةٍ عَرْضُهَا السَّمَاوَاتُ وَالْأَرْضُ
 الَّذِينَ يُنْفِقُونَ فِي السَّرَّاءِ وَالضَّرَّاءِ (١٣٣) أُعِدَّتْ لِلْمُتَّقِينَ
 وَاللَّهُ يُجِيبُ الْمُحْسِنِينَ وَالْكَاطِمِينَ الْعِظَمَاءَ وَالْعَافِينَ عَنِ النَّاسِ

“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit.”⁶²

O Allah, o Zoti ynë që je në qiell, ne robërit e Tu të varfër karshi madhërisë Tënde të lutemi, falna në këtë ditë të bekuar!

Dhurona nga begatitë e Tua, dhurona paqe dhe harmoni në familjet tona!

O Zot, na bashko, mos na lejo të na prijnë injorantët!
 Zot ynë, jepja hairin dhe të mbarën kësaj shoqërie dhe këtij vendi!

Fali prindit tanë të gjallë dhe të vdekur, udhëzона rininë dhe drejtona parinë!

O Allah! Ti je Falës dhe e do faljen, prandaj na fal ne!

⁶² Kur'an, Al'imran: 133.

18. MUHAMEDI ALEJHI SELAM DHE SHTIMI I VEPRAVE TË MIRA NË RAMAZAN

Falënderimet i takojnë Krijuesit të botëve. Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Njëri prej sezoneve vjetore që lidhet me adhurimin është edhe muaji Ramazan, të cilin Allahu e ka madhështuar dhe nderuar, kurse ata që e respektojnë i ka privilegjuar me shpërblime të panumërta në Ditën e Kiametit. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *Allahuthotë: “Çdo vepër e birit të Ademit shpërblehet me dhjetë sevape deri në shtatëqind. Përveç agjërimit, ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të.”*⁶³ Duke u nisur nga madhështia e muajit Ramazan, besimtari arrin në përfundimin se Ramazani është rasti më i favorshëm për të garuar për vepra të mira sepse infrastrukturën që Ramazani u jep besimtarëve për të vepruar, ndryshuar dhe fituar shpërblime nuk mund ta gjejnë në muajt e tjerë.

Sa herë që del hëna e Ramazanit, ngjall tek ne përkujtimet e jetës së të Dërguarit Muhamed, sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, për të kujtuar se si ishte gjendja e tij me veprat e mira, shtimi i tyre dhe të garuarit për to. Për këtë arsye, ky muaj duhet shfrytëzuar në vepra të

⁶³ Shënon Imam Buhariu, 1894.

mira, që të shtojmë në llogarinë tonë sa më shumë shpërblime. Ne kemi shëmbëlltyrën tonë, Muhamedin alejhi selam, se si ai vepronte, garonte dhe i inkurajonte të tjerët në vepra të mira.

Le të ndalemi pak dhe të shpalosim pjesë nga jeta e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në Ramazan. Për këtë më së miri na tregon shoqëruesi i tij, i biri i xhaxhait të tij, Ibn Abasi, i cili thotë: *"Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në Ramazan, kur takonte Xhibrilin, tregonte një bujari që nuk e kishte në muajt e tjerë. Ai, Xhibrili, e takonte atë për çdo natë të Ramazanit dhe e përsërisnin së bashku Kur'anin. Kështu, Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në këtë muaj ka qenë për njerëzit më i dobishëm se era pas së cilës vjen shiu."*⁶⁴

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e dallonte këtë muaj me adhurime të shumta, me të cilat nuk i dallonte muajt e tjerë, saqë ai agjëronte nganjëherë edhe pa ndërprerë, por i ndalonte nga kjo shokët e tij. Ata i thoshin "por ti po e vepron një gjë të tillë", kurse ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ua kthente përgjigjen duke u thënë: *"Unë dalloj prej jush sepse Zoti im më furnizon me ushqim"*.

Pejgamberi Muhamed sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është shëmbëlltyrë e çdo besimtari që mundohet ta kënaqë Zotin e tij, prandaj kushdo që dëshiron të bëjë vepra të mira, kur ta dëgjojë këtë përshkrim të jetës së

⁶⁴ Transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

tij, duhet të shpejtojë në vepra të mira dhe të largohet nga veprat e këqija dhe ta shfrytëzojë kohën e tij në çdo gjë që i bën dobi për këtë botë dhe botën tjetër.

Kjo shihej në jetën e muslimanëve të parë, kur garonin për vepra të mira si individë apo edhe si shoqëri.

Ja një shembull praktik i garimit individual në vepra të mira i një besimtari ambicioz me zemër të sinqertë.

"Përcillet nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë:

- Kush nga ju sot është agjërues?

Ebu Bekri tha: -Unë.

- Kush nga ju ka përcjellë një xhenaze?

Ebu Bekri tha: -Unë.

- Kush nga ju ka ushqyer një të varfër?

Ebu Bekri tha: -Unë.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: -Nuk bashkohen këto te ndonjë person veçse do të hyjë në xhenet."

Nuk ka dyshim se çdo garues ëndërron vendin e parë.

Në të njëjtën kohë, frytet e garës për vepra të mira kanë rezultate të frytshme e të kënaqshme në dynja dhe ahiret. Allahu i Madhëruar thotë:

وَسَارِعُوا إِلَىٰ مَغْفِرَةٍ مِّن رَّبِّكُمْ وَجَنَّةٍ عَرْضُهَا السَّمَاوَاتُ وَالْأَرْضُ
الَّذِينَ يُنْفِقُونَ فِي السَّرَّاءِ وَالضَّرَّاءِ ﴿١٣٣﴾ أُعِدَّتْ لِلْمُنْفِقِينَ
وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ وَالْكَاطِمِينَ الْغَيْظِ وَالْعَافِينَ عَنِ النَّاسِ

“Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.”⁶⁵

Fryti më madhor i garimit në vepra të mira është afrimi te Zoti i gjithësisë.

Allahu thotë:

أُولَٰئِكَ الْمُقَرَّبُونَ ﴿١٠﴾ وَالسَّابِقُونَ السَّابِقُونَ

“...dhe ata që kanë prirë (në besim) e që do të prijnë (edhe në xhenet). Ata janë të afërtit (tek Allahu).”⁶⁶

Imam Shafiu ka thënë: “Dua që njeriu të jetë bujar në Ramazan duke pasuar Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem për shkak të nevojës së njerëzve dhe preokupimit të tyre me agjërimin dhe namazin në raport me furnizimin e tyre.”

Të nderuar vëllezër!

Dyert e hairit janë të hapura në çdo vend dhe në çdo kohë. Musliman i mençur është ai që shpejton në

⁶⁵ Kur'an, Al'imran: 133-134.

⁶⁶ Kur'an, Vakia: 10-11.

vepra të mira dhe i vjel të mirat e tyre, posaçërisht në Ramazan, si muaji i të mirave dhe i bereqetit, në të cilin shumëfishohen shpërblimet.

19. VLERA E NETËVE TË FUNDIT

Të nderuar besimtarë!

Të mirat e Ramazanit nuk kanë fund, nuk mund të numërohen. Ramazani është ndryshe nga gjërat e tjera në jetën e kësaj bote sepse kur gjërat fillojnë të përfundojnë, u përfundojnë edhe të mirat edhe dobietë e tyre, ndërsa ky rregull nuk vlen për këtë muaj të shenjtë. Ramazanit sa herë që i afrohen ditët e fundit, i shtohet madhështia dhe vlera. Për këtë arsye, besimtari kur vjen fundi i Ramazanit duhet të jetë i vetëdijshëm që ta shtojë aktivitetin e vet dhe të japë maksimumin në garimin për vepra të mira.

Të respektuar agjërues!

Gjendemi në atë që quhet dhjetëshja e fundit në këto ditë të bekuara të këtij muaji, ditë faljeje nga i madhi Allah. Në këto ditë ku gjendet një natë që ka vlerë më shumë se 1000 muaj, në këto net kur Allahu liron robërit e Tij nga zjarri i xhehenemit. Por shtrohet pyetja, sa jemi të informuar për këto ditë të bekuara? Të ndalemi pak që të rikujtojmë së bashku ajetet kur'anore dhe hadithet profetike që flasin për vlerën dhe rëndësinë e këtyre netëve të bekuara.

Në këto net gjendet Nata e Kadrit, një natë shumë e veçantë që sjell mëshirën, kënaqësinë dhe faljen e Allahut. Allahu thotë:

لَيْلَةُ ﴿٢﴾ وَمَا أَدْرَاكَ مَا لَيْلَةُ الْقَدْرِ ﴿١﴾ إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ فِي لَيْلَةِ الْقَدْرِ
تَنْزِيلُ الْمَلَائِكَةِ وَالرُّوحِ فِيهَا بِإِذْنِ ﴿٣﴾ الْقَدْرِ خَيْرٌ مِّنْ أَلْفِ شَهْرٍ
﴿٥﴾ سَلَامٌ هِيَ حَتَّىٰ مَطْلَعِ الْفَجْرِ ﴿٤﴾ رَبِّهِمْ مِّنْ كُلِّ أَمْرٍ

1. Ne e kemi zbritur (Kur'anin) në Natën e Kadrit.
2. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është nata e Kadrit?
3. Nata e Kadrit është më e mirë se një mijë muaj.
4. Engjëjt dhe Shpirti (Xhebraili), me lejen e Zotit të tyre, zbresin në këtë natë, me të gjitha vendimet.⁶⁷
5. Paqe është ajo deri në lindjen e agimit.

Në këtë natë zbriti Kur'ani, melekët zbresin në tokë dhe sjellin paqe për besimtarët. A nuk ia vlen që ne të jemi më të zgjuar, që kjo natë të na takojë më të përkushtuar ndaj Zotit tonë? Të falesh në këtë natë do të thotë sikur je falur më shumë se një mijë muaj, që janë të barabartë me 83 vite e 4 muaj. Këto net edhe për Pejgamberin e Allahut ishin më të veçanta se netët e tjera të Ramazanit.

⁶⁷ “Nata e Kadrit” do të thotë “Nata e Caktimit”. Në këtë natë, Allahu i Madhëruar ka filluar t’i shpallë Kur'anin Muhamedit (a.s.). Ajo është një nga netët teke të 10-ditëshittë fundit të muajit Ramazan. Gjatë saj engjëjt zbresin me të gjitha vendimet hyjnore për çfarë do të ndodhë në Tokë brenda një viti.

Në të dy sahihët transmetohet se Aishja radijAllahu anha ka thënë: *“Me të nisur dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem shtrëngonte rripin (largohej prej grave dhe i përvishëj adhurimit), gjallëronte natën (me adhurime; namaz, Kur'an, dhikr) dhe zgjonte familjen e tij (për adhurim)⁶⁸.”*

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i veçonte dhjetë netët e fundit me disa vepra të cilat nuk i bënte në pjesën tjetër të muajit, si:

- 1) Gjallërimi i natës me adhurim.
- 2) I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e zgjonte familjen e tij për namaz në dhjetë netët e fundit, çka nuk e bënte në netët e tjera.
- 3) I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në këto dhjetë ditë e shtrëngonte rripin. E vërteta e kësaj është se kjo nënkupton largimin prej grave (për t'iu përkushtuar adhurimit). Kështu e kanë interpretuar dijetarët e hershëm.
- 4) Itikafi. Në të dy sahihët përcillet se Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: *“I Dërguari i Allahut bënte gjithnjë itikaf në dhjetë netët e fundit, derisa vdiq.”* Itikaf është izolim që nënkupton ndërprerjen e lidhjeve me krijesat për t'iu përkushtuar Krijuesit.

⁶⁸ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

5) Nata e Kadrit. Nga Ebu Hurejra radijAllahu anhu transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: "*Ai që fal namazin e natës në Natën e Kadrit me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu), i falen të gjitha gjynahet që ka bërë.*"⁶⁹

Të nxitojmë sa më parë për të shfrytëzuar kohën e mbetur të këtij muaji për punë të mira, duke shpresuar te kompensimi i kohës së humbur gjatë jetës sonë.

6) Lutja e veçantë në këto net. Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, i tha të Dërguarit sal-Allahu alejhi ue sel-lem: "Çfarë duhet të them nëse e arrij Natën e Kadrit?" Ai i tha: "*O Allah! Ti je Falës dhe e do faljen, prandaj më fal!*"⁷⁰

El-Afuë, Falës, është prej emrave të bukur të Allahut dhe quhet Ai që i fal mëkatet e robërve të Tij dhe i shlyen gjurmët e tyre. Allahu e do faljen dhe dëshiron t'i falë robërit e Vet. Po ashtu, Ai dëshiron që robërit e Tij ta falin njëri-tjetrin dhe kur ata e falin njëri-tjetrin, Ai i fal ata. Për Të falja është më e dashur se ndëshkimi.

Të nderuar agjërues, ju vëllezër dhe motra!

A nuk është bukur që së paku në këto dhjetë netët e fundit ta marrim këtë mesazh që na jep Ramazani? Përpjekjet tona në këtë muaj i bëjmë që të arrijmë

⁶⁹ Shënojnë Buhariu dhe Muslimi.

⁷⁰ Shënon Termidhiu.

faljen e Allahut dhe dëshira e çdo besimtarit është që ta arrijë atë. A nuk do të ishte mirë që kjo dua të lërë gjurmë në zemrat tona dhe të lërë tek ne mesazhin e saj, që ne të mësojmë t’i falim të tjerët dhe të njëjtën kohë të kërkojmë falje për atë që u bëjmë njerëzve pa vetëdije dhe me vetëdije?

A nuk e bënte Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem këtë lutje:

‘O Allahu im, cilitdo besimtari që e kam ofenduar, ktheja atë në pastrim për mëkatet e tij!’ Omeri radij-Allahu anhu kërkoi falje për shkarkimin e Halid bin Velidit nga drejtimi i ushtrisë. A nuk ishin vëllezërit e Jusufit alejhi selam të cilët kërkuan nga babai i tyre, Jakubi alejhi selam, falje për gabimet e tyre? Historia dëshmon se njerëzit e mëdhenj kanë kërkuar falje para popullit të tyre për shkak të dështimeve.

Kjo etikë hyjnore dhe kulturë botërore ishte edhe në fjalorin e dijetarëve, të cilët kanë kërkuar falje dhe ndjesë për gabimet dhe lëshimet që kishin bërë.

Të nderuar vëllezër!

A nuk është bukur që në këto net të bekuara edhe ne të mësojmë të kërkojmë falje e të themi:

- Zot, më fal për mëkatet e mia!
- Prindër, më falni që nuk po ju respektoj ashtu si duhet!
- Grua, më fal sepse t’i meriton më shumë për kontributin tënd!

- Fëmijë, faleni babin sepse shpesh vonohem me angazhime e nuk po ju dhuroj atë që kërkoni nga unë!

- O ti fukara dhe o ti jetim, më fal se unë kisha mundësi, por nuk e shtriva dorën!

Fjalë e rëndë për t'u shqiptuar, me përjashtim të atyre që Zoti i mëshiron.

Sa bukur do të ishte ta mësonin udhëheqësit tanë shprehjen “më fal” dhe kur dështojnë dhe nuk i realizojnë premtimet e tyre, së paku t'i thonë popullit “më fal o populli im”.

O Allah, o Zoti ynë, na fal e na mëshiro në këto net të bekuara, zbrit mbi ne faljen Tënde dhe paqen për gjithë njerëzimin! O Zot, ndihmoji muslimanët kudo që janë!

Të nderuar vëllezër dhe motra!

Allahu jua pranofte agjërimin!

20. ITIKAFI

Itikaf është të qëndruarit në xhami me nijet të caktuar, për t'i bërë ibadet Allahut të Lartësuar, edhe në qoftë një orë natën ose ditën, ndërsa nuk kushtëzohet pastrimi (gusli) për të.

Dispozitat e itikafit

Është sunet në çdo kohë, e në Ramazan është më e sigurt, e në dhjetë ditët e fundit edhe më shumë, siç transmetohet nga Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) që ka thënë: "Ka qëndruar i Dërguari (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) në itikaf dhjetë ditët e fundit të Ramazanit derisa vdiq, pastaj kanë qëndruar gratë e tij."⁷¹

Imam Ahmedi Allahu e mëshiroftë ka thënë: "Nuk di se dikush nga dijetarët e ka kundërshtuar mendimin se itikafi s'është sunet."⁷²

A kushtëzohet për itikafin agjërimi?

Mendimi më i saktë është se nuk kushtëzohet agjërimi për itikaf. Në qoftë se do të kushtëzohej një gjë e tillë, nuk do të llogaritej itikafi i natës, sepse natën nuk ka agjërim.

⁷¹ Shënon Buhariu.

⁷² Shënon Ebu Davudi.

Kur bëhet itikafi obligim vaxhib

Ibn Mundhiri ka thënë: "Kanë rënë në pajtim dijetarët se itikafi nuk është obligim, vetëm nëse njeriu ia bën vetes obligim me anë të zotimit (nedhrit). Këtë e argumenton fjala e Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të), ku thotë: "Ai që është zotuar që ta respektojë Allahun, le ta respektojë." ⁷³

Kush zotohet që të bëjë itikaf një ditë obligohet për atë itikaf; kush zotohet që të bëjë itikafin agjërueshëm obligohet ta bëjë itikafin para agimit e deri në perëndim të diellit; e kush zotohet ta bëjë itikafin agjërueshëm obligohet të rrijë gjatë ditës, qoftë edhe një orë, sepse ai duhet që të qëndrojë në itikaf agjërueshëm.

Kushtet e itikafit

- Islami.
- Nijeti.
- Logjika (të jetë i mençur). Fëmija, qoftë mashkull ose femër, nëse qëndron në itikaf, itikafi i tij është i saktë.
- Itikafi të jetë në xhami ku falen namazet me xhemat.

Vendi i itikafit

Itikafi bëhet në çdo xhami në të cilën falet namazi me xhemat, në cilindo vend që të jetë e më së miri të jetë në xhami ku falet namazi i xhumasë, që mos të ketë

⁷³ Shënon Buhariu.

nevojë të dalë nga xhamia kur të vijë koha e namazit të xhumasë. Por, nëse nuk gjen xhami të tillë, atëherë bën itikaf aty ku ka mundësi dhe ka të drejtë të shkojë pastaj që ta falë namazin e xhumasë.²

Kur fillon koha e hyrjes në itikaf

Shumica e dijetarëve janë të mendimit se itikafi fillon në natën e njëzet e një të muajit Ramazan.

Kur del personi nga itikafi

Personi del nga vendi i itikafit pas perëndimit të diellit natën e Bajramit.

Gjërat e pëlqyeshme gjatë itikafit

Duhet që personi që bën itikaf të angazhohet me ibadet ndaj Allahut të Lartësuar me lexim të Kur'anit, dua, dhikër, namaz nafile (vullnetar) e të tjera, e mos ta kalojë kohën me gjëra që nuk kanë dobi.

Gjërat e ndaluara në itikaf

Personi që qëndron në itikaf duhet t'i lërë gjërat që si bëjnë dobi prej fjalëve dhe veprave, gjithashtu, polemikën dhe teprimin në bisedë apo ajo që është e ngjashme me të. Muhamedi (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Prej të mirave të Islamit është që ta lërë njeriu atë që nuk i intereson."⁷⁴

⁷⁴ Shënon Ibn Maxhe, Termidhiu dhe Begaviu.

Gjërat që e prishin itikafin

1. Marrëdhëniet intime. Këtë e argumenton Fjala e Allahut të Lartësuar ku thotë:

وَلَا تَبَاشِرُوهُنَّ وَأَنْتُمْ عَاكِفُونَ فِي الْمَسَاجِدِ

*"E kur jeni të izoluar në xhamia (në itika), mos u afroni atyre (për marrëdhënie intime)."*⁷⁵

2. Dalja nga xhamia pa patur nevojë të domosdoshme. E kanë përmendur disa dijetarë që prishet, nëse personi vepron mëkate të mëdha ose ndonjë nga gjërat e ndaluara (haramet).

A i lejohet personit që rri në itikaf të dalë nga xhamia?

Daljen nga xhamia në këtë gjendje dijetarët e kanë ndarë në tri pjesë:

1. E lejuar. Kjo është dalja për një çështje të domosdoshme qoftë ajo e lidhur me çështje fetare ose çështje të natyrshme, si p.sh. dalja për namaz të xhumasë; për të ngrënë ose për të pirë, nëse nuk ka njeri që t'ia sjellë këto gjëra; dalja për abdeste pastrim kur janë të obliguar, ose për të kryer nevojë personale.
2. Dalja që ka të bëjë me adhurime jo të obligueshme, si p.sh. vizita e të sëmurit, përcjellja e xhenazes. Kjo

⁷⁵ Kur'an, Bekare: 187.

lejohet vetëm nëse e ka kushtëzuar në fillim të itikafit, përndryshe nuk lejohet.

3. Dalja për një çështje që e prish itikafin, si p.sh. dalja për shitblerje, për marrëdhënie me gruan; kjo nuk lejohet as me kushtëzim e as pa kushtëzim.

Me fjalë të tjera, itikaf është të izoluarit e vetvetes në xhami, për një kohë të caktuar, me qëllim për t'i bërë ibadet Allahut të Lartësuar. Është e lejuar në çdo kohë për mashkullin ose femrën, por më e pëlqyeshme është në muajin Ramazan; në dhjetë ditët e fundit dhe ky është Suneti i Pejgamberit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

Duhet ditur se nëse ka mundësi të bëhet itikafi në harem (xhamia në Mekë ose në Medinë ose në Xhaminë Aksa) shpërblimi është më i madh, sepse edhe namazet në to e kanë vlerën e dyfishuar, siç ka ardhur në shumë hadithe të sakta të Pejgamberit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të).

21. KËSHILLAT E RAMAZANIT QË PO LARGOHET

Nuk ka dyshim se shkolla e madhe që quhet Ramazan ka shumë mirësi, mësim, mesazhe e këshilla të cilat na i jep gjatë ditëve që ne mësojmë në bankat e saj. E veçanta e tij është se ai pas lë edhe disa këshilla të arta për ata që duan të mësojnë, që t'i marrin si fanar në jetë derisa të kthehet ai.

Disa nga këshillat e Ramazanit janë:

1. Kush ka adhuruar Ramazanin, ai po shkon, por kush ka adhuruar Allahun përmes Ramazanit, Allahu është i gjallë.
2. Vepra më e dashur tek Allahu është vepra e vazhdueshme edhe nëse është e paktë. Pas Ramazanit ka edhe shumë vepra të mira me të cilat njeriu fiton xhenetin, prandaj kërkohet vazhdimësi në vepra të mira edhe nëse janë të pakta.
3. Nevoja e njeriut për Zotin e vet është e pashmangshme, ndaj njeriu duhet të qëndrojë besnik në lidhje me Allahun.
4. Ramazani kërkon nga ti që ashtu siç u ruajte në Ramazan nga ushqimi, pijet dhe gjërat e ndaluara, të ruhesh edhe pas Ramazanit.
5. Ramazani është garanci se ti ke mundësi të ndryshosh për mirë çdo herë, nëse vullneti ekziston.

6. Njerëzit nevojtarë kanë nevojë për ty edhe jashtë Ramazanit. Bëhu bujar me ta edhe pas Ramazanit!
7. Sjellja, etika ishte ajo që të dalloi në Ramazan. Bëhu i tillë edhe jashtë Ramazanit!
8. Nëse në Ramazan kishe mundësi të falje 20 rekate në namazin e natës, ti ke mundësi të falesh pesë herë në ditë.
9. Mos u shndërro në musliman sezonal një herë në javë, një herë në muaj, njëherë në vit!
10. Mos e thyej besën që i ke dhënë Allahut!

22. RAMAZANI DHE JUSUFI A.S.

إِذْ قَالَ يُوسُفُ لِأَبِيهِ يَا أَبَتِ إِنِّي رَأَيْتُ أَحَدَ عَشَرَ كَوْكَبًا وَالشَّمْسَ
وَالْقَمَرَ رَأَيْتُهُمْ لِي سَاجِدِينَ

‘Kur i tha Jusufi babait të tij: “O babai im, kam parë në ëndërr njëmbëdhjetë yje, edhe Diellin edhe Hënën e kam parë, si më bënëin sexhde mua.”⁷⁶

Nuk ka dyshim se mes Ramazanit dhe Jusufit a.s. ka një ngjashmëri të madhe, ka të përbashkëta që lidhen në shumë pika.

Ja disa nga këto ngjashmëri:

1. Njëmbëdhjetë vëllezërit e Jusufit janë njëmbëdhjetë muajt e vitit, ndërsa Jusufi a.s. zëvendëson muajin Ramazan.
2. Jakubi a.s. është simbol i hënës, e cila është shenjë për ardhjen e muajit të shenjtë të Ramazanit, ashtu siç ishte ai shenjë se me Jusufin a.s. do të ndodhnin mrekulli.
3. Njeriut gjatë njëmbëdhjetë muajve të vitit i mbushet zemra me zili, mëkate, hakmarrje, shantazhe, kurthe ashtu siç u mbushën njëmbëdhjetë vëllezërit e Jusufit a.s., por erdhi Jusufi dhe u dha mundësinë që gjithçka e keqe të fshihet, ashtu siç është Ramazani në raport me ne.

⁷⁶ Kur'an, Jusuf: 3.

4. Muaji i Ramazanit ka një lidhje të madhe me Jusufin a.s., duke u nisur nga dashuria. Ashtu si Jusufi ishte i dashur karshi vëllezërve të tij tek babai i tij, po ashtu Ramazani përballë muajve të tjerë është më i dashuri tek Allahu.
5. Jusufi ishte model i durimit, po ashtu Ramazani është shkollë ku ne mësojmë durimin dhe si t'i sfidojmë gjërat në jetë.
6. Ashtu si Jusufi e ruajti veten nga joshjet e epshit, vjen Ramazani dhe na mëson si duhet t'u ikë njeriu joshjeve të epshit në këtë botë, duke shkuar deri në atë masë sa na bën të privojmë edhe vetes që mos të kemi asnjë kontakt me të gjatë ditës kur ne agjërojmë.
7. Ramazani ua kalon muajve të tjerë ashtu si Jusufi ua fali vëllezërve të tij gjithçka që kishin bërë. Kur i tha:

وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ يَغْفِرُ اللَّهُ لَكُمْ قَالَ لَا تَتْرِبَ عَلَيْكُمُ الْيَوْمَ

“Unë, -tha ai, -sot nuk kam qortim për ju, Allahu do t'ju falë, Ai është i mëshirshmi mëshirëplotë.”⁷⁷

8. Vëllezërit e Jusufit a.s. u mbështetën në fund tek ai për të rregulluar atë çfarë kishin prishur. Po kështu Ramazani i ofron njeriut alternativën për të

⁷⁷ Kur'an, Jusuf: 92.

rregulluar atë çfarë ka prishur në shpirtëroren dhe fizikun e tij gjatë njëmbëdhjetë muajve të tjerë.

9. Jakubia.s. u verbua dhe nuk iu kthye shikimi edhe pse njëmbëdhjetë bijtë e tij ishin prezentë, por iu kthye shikimi vetëm atëherë kur erdhi Jusufi a.s.. Kështu është halli ynë, ne shpeshherë ngarkohemi me mëkate, por nuk i shohim vetëm se atëherë kur vjen Ramazani dhe e shohim veten se sa larg kemi qenë nga rruga e Zotit. Ramazani na jep shikim, energji, forcë për ta parë rrugën e drejtë ashtu siç ishte Jusufi a.s. shkaktar për t'ia sjellë shikimin Jakubit a.s..
10. Ashtu si përfundon ky rrëfim me një përfundim të mirë dhe në favor të të gjithë protagonistëve, po ashtu çdo person që është në sofrën e Ramazanit në fund të tij do të ndahet i kënaqur.

Zot! Bëje të dashur Ramazanin ashtu siç e bëre Jusufin të dashur për zemrën e Jakubit a.s.!

*Bëje Ramazanin shkaktar për faljen e mëkateve tona!
Ramazani le të jetë dritë që na ndriçon rrugën për të ardhur tek falja Jote. Mblidhi zemrat tona, afrona mes vete në familje, fis e shoqëri ashtu si Ramazani na bashkon të gjithëve rreth sofrës së tij!*

Zot, falna me faljen që Ti di të falësh!

23. LAMTUMIRË RAMAZAN!

Kur i vjen fundi muajit Ramazan, ai e ka dërguar tashmë mesazhin e tij tek zemrat e besimtarëve, ngase Ramazani është pjesë e jetës sonë. Siç përfundoi edhe ky muaj, ashtu do të përfundojë edhe jeta jonë dhe më pas do të gëzohen një grup njerëzish dhe do të dëshpërohen grupi tjetër.

Ata që do të gëzohen në fund të Ramazanit apo në fund të jetës së tyre janë ata që kanë fituar çmimin e kënaqësisë së Allahut xhelexhelalehu. Kush ka respektuar dispozitat e Tij, e ka shfrytëzuar kohën dhe e ka ndaluar veten nga gjërat që e zbehin agjërimin dhe ka bërë përpjekje për t'i shtuar të mirat e për t'i pakësuar të këqijat, ai e meriton këtë çmim të madh që Allahu xhelexhelalehu do t'ua dhurojë agjëruesve.

Transmetohet nga Ebu Xhafer Muhamed bin Alij se ka thënë: “Kush e ka takuar Ramazanin duke qenë shëndosh si musliman, ka agjëruar ditën dhe është falur në një pjesë të natës, ka ulur shikimin, ka ruajtur epshin, gjuhën dhe dorën e tij, është falur me xhemat dhe ka nxituar për në namazin e xhumasë, ai e ka agjëruar muajin Ramazan dhe ka arritur shpërblimin, e ka gjetur Natën e Kadrit dhe e ka merituar çmimin e Allahut.”

Besimtari duhet ta falënderojë Allahun që ia mundësoi që edhe këtë pjesë të jetës së tij ta kalojë në adhurim.

Allahu ka urdhëruar që në fund të muajit Ramazan ta madhërojmë Atë xhelexhelalehu.

وَلِتُكَبِّرُوا اللَّهَ عَلَىٰ مَا هَدَاكُمْ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ

“...ta madhëroni Allahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni.”⁷⁸

Falënderimet gjithmonë i takojnë Allahut, i Cili na mundësoi që ta arrijmë edhe këtë muaj dhe ta përcjellim me agjërim, duke e lutur gjithmonë Krijuesin që ta meritojmë çmimin e Tij: faljen dhe lirimimin nga zjarri i xhehenemit.

Për pjesën e ajetit,

وَلِتُكَبِّرُوا اللَّهَ عَلَىٰ مَا هَدَاكُمْ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ

“...ta madhëroni Allahun për atë se u udhëzoi.”⁷⁹

Imam Kurtubij thotë: “Ju ka udhëzuar nga ajo që të krishterët devijuan duke ndryshuar agjërimin e tyre.”⁸⁰

“Kush e ka agjëruar Ramazanin me iman dhe duke qenë i bindur në Allahun, i është dhënë premtimi nga

⁷⁸ Kur’an, Bekare: 185.

⁷⁹ Kur’an, Bekare: 185.

⁸⁰ Shih “Tefsir Kurtubij”, komentimi i kaptinës Bekare, 185.

gjuha e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem se do t'i falen mëkatet, por jo ato të mëdhatë.”

Besimtari nuk duhet ta anashkalojë çmimin e Ramazanit. Pse? Sepse nganjëherë mëkatet e vogla sjellin ato të mëdha. Mëkati i madh falet vetëm me pendim apo nëse është e drejtë e njeriut, duhet që ai ta falë atë. Këtu shihet çmimi i Ramazanit: kur Allahu bën që në të lirohemi nga zjarri i xhehenemit, atëherë vërtet kjo është fitorja e madhe dhe lumturia më e madhe në dy botët. Kush e meriton, ka vërtet Bajram, por kush privohet, është i dështuar në dyja botët.

Ibn Rexhepi, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Dita e parë e muajit Sheval është ditë Bajrami për gjithë umetin ngase në këtë ditë Allahu liron nga zjarri i xhehenemit ata që kanë vepruar mëkate të mëdha. Agjëruesit dhe mëkatarët përzihen me të devotshmit për shkak të faljes së tyre. Kështu është dhe dita e therjes (Kurban Bajrami), ngase një ditë para kësaj feste është dita e Arafatit, një ditë e papërsëritshme në këtë jetë, pasi Allahu liron më shumë njerëz nga zjarri i xhehenemit. Kush lirohet në këto dy ditë, ai vërtet ka festë.

Transmetohet nga Ibn Abasi se “në ditën e Bajramit zbresin engjëjt në tokë duke qëndruar në çdo skaj të rrugëve. Ata thërrasin me zë që e dëgjon çdo krijesë përpos xhinëve dhe njerëzve dhe thonë: -O umet i Muhamedit! Dilni para Allahut Fisnik, që t'ua japë

shpërblimin dhe t'ua falë mëkatet! E kur njerëzit dalin në ditën e Bajramit (për ta falur Bajramin), Allahu azeuexhele u thotë melaikeve: “Cili është shpërblimi për atë që punon?” Thonë: “Zoti ynë, që t'i jepet ajo që meriton.” Allahu thotë: “Ju jeni dëshmitarë se Unë për shkak të agjërimit dhe namazit të tyre kam bërë që shpërblimi për ta të jetë kënaqësia dhe falja Ime. Kthehuni të falur!”

24. PO PAS RAMAZANIT?

Vëllezër të nderuar!

Dijeni se Ramazani i këtij viti shkoi, por duhet ta dimë se Zoti xhelexhelalehu, i Cili e ka bërë këtë Ramazan obligim për ne, mbetet dhe është i përjetshëm, prandaj me përfundimin e Ramazanit nuk kanë përfunduar punët e mira; ato vazhdojnë dhe besimtari duhet të jetë në kontakt me Zotin e tij.

Nëse do shpërblim sikur të agjërosh tërë vitin, atëherë mos të të ikë agjërimi i gjashtë ditëve të muajit Sheval (muaj që vjen menjëherë pas Ramazanit). Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem ka thënë: *“Kush e ka agjëruar Ramazanin e më pas e pason me gjashtë ditë nga Shevati, është sikur të agjërojë tërë vitin.”*⁸¹

Nëse do që tërë vitin të të llogaritet se je agjërueshëm, atëherë mos e lë pa agjëruar.

Kështu, të dashur vëllezër, agjëruesit dalin të gëzuar, të lumtur për ditën e faljes, ditën e mëshirës, ditën e Bajramit, kur Allahu çdo agjëruesi do t'i dhurojë çmimin e merituar.

Ndërsa të dëshpëruar janë ata që nuk e respektuan mysafirin e Allahut dhe do të dëshpërohen edhe më shumë atë ditë kur do të dalin para Allahut, kur Allahu do t'i nderojë agjëruesit, kurse këta do të jenë të poshtëruar, kokulur për kohën që e kaluan kot.

⁸¹ Shënon Muslimi.

I nderuar vëlla!

Në fund të këtij muaji të shenjtë jepja besën Allahut se do të qëndrosh në rrugën e Tij, do t'i respektosh urdhrat e Tij ashtu siç e respektove mysafirin e Tij. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem këtë e bënte çdo ditë kur lindte dhe perëndonte dielli dhe thoshte: “O Allah, Ti je Zoti im, nuk ka të adhuruar përveç Teje, Ti më ke krijuar dhe unë jam robi Yt, do të qëndroj besnik ndaj marrëveshjes dhe premtimit Tënd sa të kem mundësi. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që kam vepruar, unë jam mirënjohës ndaj dhuntive të Tua, i pranoj mëkatet e mia, andaj më fal, ngase mëkatet nuk i fal askush tjetër përveç Teje.”⁸²

O Zot! Na mundëso ta arrijmë Ramazanin për shumë vite me nënshtrim ndaj Teje dhe për shumë vite Ti të jesh i kënaqur me ne!

Na e prano namazin, agjërimin, leximin e Kur'anit dhe çdo vepër që e kemi bërë për Ty!

⁸² Shënon Buhariu.

25. MË FAL RAMAZAN!

Fjalët *më fal* i do miku dhe armiku, zbuten zemrat në kohën kur vlojnë nga hidhërimi, inati, hakmarrja. E tha baba i njerëzimit Ademi alejhi selam kur gaboi. Është pjesë e fjalorit të njerëzve më të mirë që njohu njerëzia, Pejgamberët e Allahut. Mbretër e burrështetas e shqiptuan kur gabuan karshi popullit të tyre. Pejgamberi Muhamed sal-Allahu alejhi ue sel-lem e thoshte dhe i mësonte të tjerët që ta thonë.

Këtë fjalë e tha edhe burri i madh i këtij umeti, Omeri radijAllahu anhu. Kjo tregon kulturën, vlerat, personalitetin, virtytet e një njeriu që e thotë.

Koha më e mirë për ta shprehur këtë fjalë është kur je në pozitën dhe anën e të fortit.

Ju kujtohen ato ditë kur ne pritëm mysafirin e Allahut në shtëpitë tona? Kur ne mësonim si të silleshim me të? Ja, ky tani po shkon e duhet t'i kërkojmë falje.

Më fal Ramazan!

Më fal sepse nuk u solla me ty siç duhet të sillet nikoqiri me mysafirin.

Më fal sepse shpesh të rëndoja me fjalë dhe bëja shaka “e ka zënë Ramazani”, “e ka lodhur Ramazani”, “ja po e përzë Ramazanin”.

Më fal kur ti u ndieje i shqetësuar kur unë ngatërrrohesha me njerëzit e ti këtë nuk e pëlqen.

Më fal kur para teje unë përgojoja, mashtroja njerëzit e ti na mëzove të kundërtën.

Më fal sepse unë në ditët e tua e harxhoja kohën para televizorit duke shikuar filma, seriale e lojëra, kurse ti nuk i shikon këto.

Më fal për ditët që kalova pa agjëruar. Kam turp, kam frikë që ndoshta do të vijë një ditë kur unë do të të dua, por ti nuk do të më pranosh sepse unë atëherë mund të jem i sëmurë.

Më fal sepse

- kohën më të madhe e kalova në gjumë, kurse ty të lashë vetëm duke më pritur që të zgjohem;
- kohën nuk e kaloja me Kur'an;
- shumë namaze i anashkalova;
- teravitë nuk i fala me rregull, edhe pse ti ma kërkoje;
- sofrën unë e mbushja plot e ti më thoshe ndaj edhe pak për të varfrin.

Ramazan, më fal!

Të kërkoj falje në emër të popullit tim ata, të atyre që janë nga gjaku im, që flasin të njëjtën gjuhë, ata që i thonë vetes muslimanë dhe nuk ta hapën derën. Vinte syfyri, kaloja pranë shtëpive të tyre e ata ishin në gjumë. Vinte iftari e ata nuk bënë iftar me ne sepse iftar e kishin tërë ditën.

Më fal në emër të tyre sepse ata nuk dinë.

O Zot, na fal për çdo lëshim që bëmë në këtë muaj.

Kërkojmë kënaqësinë dhe shpërblimin Tënd.

Zot, bëje zjarrin haram për ne!

O Allah, o Zoti i gjithësisë, fladitna atë ditë ku nuk ka flad pos fladit që Ti na ofron. O Zot, ashtu siç gëzoheshim në kohën e iftarit, mundësona të gëzohemi ditën kur të takojmë Ty!

Ndihmona ta mposhtim epshin, armikun tonë!

O Zot, çdo muslimani mbi rruzullin tokësor ruaja gjakun, pasurinë e nderin!

Zot, ruaj vëllezërit tanë. Bëje Bajramin fitore për ta. Mposhte armikun e tyre se ata janë të mallkuar. Shpalose fuqinë Tënd mbi ta. Ti je i pamposhtur. Ktheja gëzimin, largoja pikëllimin, dhembjet shndërr-oja në rehati për këto ditë Bajrami!

Zot, bëji fytyrat e muslimanëve të qeshin në këtë Bajram në dynja dhe në ahiret!

26. JETA PAS RAMAZANIT

Falënderimet i takojnë Allahut që na udhëzoi në Islam, se sikur të mos na udhëzonte Allahu, nuk do të ishim nga të udhëzuarit. Atë e falënderojmë dhe e madhërojmë. Jemi krenarë që e njohim Allahun ashtu si duhet, pasi shumica e njerëzve nuk e njohin Atë. Jemi krenarë që e adhurojmë si të vetëm duke mos i shoqëruar askënd si rival. Jemi krenarë që falemi dhe agjërojmë e të tjerët nuk i njohin këto adhurime.

فَمَنْ وَإِنَّمَا تُؤَفَّقُونَ أَجُورَكُمْ يَوْمَ الْقِيَامَةِ كُلُّ نَفْسٍ ذَائِقَةُ الْمَوْتِ
وَمَا الْحَيَاةُ الدُّنْيَا إِلَّا مَتَاعٌ زُحْرَخَ عَنِ النَّارِ وَأُدْخِلَ الْجَنَّةَ فَقَدْ فَازَ
الْعُرُورُ

“Çdo shpirt do ta shijojë vdekjen. Shpërblimet do t’u plotësohen vetëm në Ditën e Kiametit; kushdo që shpëton nga zjarri i xhehenemit dhe hyn në xhenet, ai ka fituar (gjithçka që mund të dëshirohet). Ndërsa jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese.”⁸³

Të nderuar vëllezër!

Ky është ligji i Allahut, që nuk ndryshohet, “çdo shpirt do ta shijojë vdekjen”.⁸⁴ Por a duhet të ndalemi këtu

⁸³ Kur’an, Al’imran: 185.

⁸⁴ Kur’an, Al’Imran, 185.

apo të mendojmë se cilat janë shpërblimet tona pas vdekjes, se a do të na gëzojnë apo hidhërojnë ato? Ramazani nuk është vetëm se një stacion gjatë rrugëtimit tonë për në botën tjetër, ku ne besimtarët duhet të ndalemi për t'u pajisur me vepra të mira dhe për të ndryshuar në jetën tonë, që ky iman dhe vullnet që na jep Ramazani të na ndihmojë në pjesën e mbetur të jetës.

A nuk është muaji i Ramazanit pikërisht ai muaj gjatë të cilit ne kërkuam fitoren e madhe, shpëtimin nga zjarri dhe hyrjen në xhenet për tridhjetë ditë? Por ne ende jemi gjallë, jeta na pret dhe duhet të punojmë për ta fituar xhenetin dhe për t'i shpëtuar zjarrit dhe që gjatë udhëtimit tonë të jemi sa më të pastër nga njollat e mëkateve, nga të cilat na pastroi Ramazani.

Pikërisht, të nderuar vëllezër, ne duhet ta pyesim veten cilën jetë dëshirojmë pas Ramazanit, atë jetë të mirë e të lumtur që na mësoi Ramazani apo atë jetë plot telashe, siç e kërkon djalli? Në këtë jetë dy janë rrugët. Allahu i Madhëruar thotë:

إِنَّا هَدَيْنَا السَّبِيلَ إِمَّا شَاكِرًا وَإِمَّا كَفُورًا

“Natyrisht që Ne i treguam atij rrugën e drejtë, që ai të jetë ose mirënjohës, ose mosmirënjohës.”⁸⁵

⁸⁵ Kur'an, Insan: 3.

Të nderuar besimtarë!

Jeta pas Ramazanit duhet të jetë ajo që Zoti kërkon prej nesh. Kjo na ndihmon edhe më shumë sepse vetëm sa dolëm nga bankat e shkollës që quhet Ramazan. Për tridhjetë ditë jetuam, mësuam, u edukuam nën hijen e tij e tash duhet patjetër që këto mësimet t'i jetësojmë sepse për çfarë agjërnuam, për ta privuar veten nga ushqimi dhe pija?! Çfarë përfituam nga Ramazani, nëse nuk shihet jetësimi i tij në jetën tonë?

27. HAPAT DREJT NJË JETE TË LUMTUR PAS RAMAZANIT

- 1) Jeta pas Ramazanit duhet të jetë për Allah dhe me Allahun, ngase Ramazani na mësoi kështu. A nuk ishte agjërimi ynë nga 17 orë në ditë për Allahun, Krijuesin Tonë, se Ai e kërkoi nga ne dhe ne u përgjigëm jetuam me Allahun duke i kryer edhe obligimet ishim më afër Tij këtë duhet ta vazhdojmë edhe pas Ramazanit që jeta jonë të jetë vetëm për Allah dhe me Allahun.
- 2) Në çdo vepër ka vend hipokrizia, pos në Ramazan jo, ngase ti ke mundësi të hash e pish pa e ditur të tjerët, por nuk e bën për shkak të sinqeritetitënd, i cili është vetëm për Allah, sepse je i bindur se Ai të sheh. Ti ke mundësi të falesh për syfaqe, të japësh, të ndihmosh, por jo edhe të agjërosh. Andaj le të jetë jeta jonë pas Ramazanit, veprat dhe punët tona vetëm për hir të Allahut, larg nga dyfaqësia dhe jo për hatër të njerëzve.
- 3) A nuk ishte objektivi kryesor që Ramazani sjell dhe boshti rreth të cilit sillet ky muaj që të mbjellë tek ne devotshmërinë duke marrë hapat e duhur që edhe pas Ramazanit ashtu si në Ramazan, kur e privuam veten nga gjërat që në esencë janë të

lejuara, t'u themi jo haramëve, pasi për to në barkun tonë nuk ka vend. Prej fjalëve të të parëve tanë të mirë ishte: “Sikur të falësh namaz sa qëndrojnë shtyllat, nuk do të të bëjë dobi derisa të shikosh se çfarë po fut në barkun tënd.”

- 4) A nuk na mësoi Ramazani se si duhet të jenë raportet tona me të tjerët nëse ata na pengojnë apo zihemi me dikë që ne t'i themi "unë jam agjërueshëm"? Sa e bukur do të ishte jeta jonë që ne të jetojmë me këtë moto edhe jashtë Ramazanit, që t'u themi të tjerëve “unë jam agjërueshëm, nuk ke punë me mua”. I suksesshëm te Zoti është ai që merret me gabimet veta dhe i lë gabimet e të tjerëve.
- 5) Sofra e iftarit ishte simbolika e unitetit familjar dhe vëllazëror se si duhet të jetojmë me të afërmit tanë edhe pas Ramazanit, andaj dije se të afërmit e tu kanë nevojë për ty dhe e meritojnë dhe e presin mbikëqyrjen tënde edhe pas Ramazanit. Mos mendo se me sadakanë e fitrit e ke kryer obligimin ndaj tyre nëse kanë nevojë. Mbajtja e lidhjeve farefisnore të çon drejt krenarisë, sjell riskun, suksesin në jetë dhe i mbush zemrat plot hare. I Dërguari sal-Allahu alejhi ue sel-lem thotë: *“Kush dëshiron që t'i shtohet risku dhe t'i zgjatet jeta, le të*

mbajë lidhjet me farefisin e tij."⁸⁶ I afërmi yt është pjesë e jotja. Nëse investon për të, ke investuar për personalitetin tënd dhe nëse nuk ke me çfarë ta ndihmosh, atëherë thuaji fjalë të mira. Urrejtja dhe konflikti mes farefisit është sherr dhe bela e madhe. Ai që mendon se ka fituar në konfliktet farefisnore është i humbur në dynja dhe ahiret. Çdo i afërm do të vijë në Ditën e Kiametit dhe do të dëshmojë për të afërmin e tij nëse i ka mbajtur lidhjet apo jo.

- 6) Vazhdimësia në vepra të mira. Nëse Ramazani ka përfunduar, veprat e mira nuk përfundojnë. Menjëherë pas Ramazanit vijnë gjashtë ditë e muajit Sheval. Pejgamberi sal-Allah u alejhi ue sel-lem ka thënë: *"Kush e ka agjëruar Ramazanin e më pas e pason me gjashtë ditë nga Shevali, është sikur të agjërojë tërë vitin."*⁸⁷

E më pas mbetet namazi, duaaja, leximi i Kur'anit, sadakaja edhe shumë vepra të mira, se Zoti është i gjallë dhe i përjetshëm. Le të jetë motoja jote "veprat le të jenë të vazhdueshme edhe nëse janë të pakta".

⁸⁶ Shënon Buhariu.

⁸⁷ Shënon Muslimi.

Frika nga mospranimi

Allahu i Madhëruar thotë:

وَالَّذِينَ يُؤْتُونَ مَا آتَوْا وَقُلُوبُهُمْ وَجِلَةٌ أَنَّهُمْ إِلَىٰ رَبِّهِمْ رَاجِعُونَ

“...dhe ata të cilët japin (sadaka-zekat) nga ajo që u është dhënë, pse dinë se do të kthehen te Zoti i tyre, andaj zemrat e tyre i kanë të frikësuar.”⁸⁸

Pejgamberi sal-Allah u alejhi ue sel-lem ka thënë për këta njerëz: *“Agjërojnë, falen, japin lëmoshë dhe kanë frikë se nuk u pranohen veprat.”⁸⁹*

Aliu, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, thotë: *“Çdo ditë që nuk i bëhet mëkat Allahut për ne është festë.”*

⁸⁸ Kur'an, Muminun: 60.

⁸⁹ Shënon Termidhiu, Bejhakiu. Shih tefsirin e Ibn Kethirit, komentimi i sures Muminun, 60.

28. FESTA E BAJRAMIT

Të nderuar vëllezër muslimanë!

Ju përshëndesim me përshëndetjen islame, eselamu alejkum ue rahmetullahu ue berekatuhu, dhe ju përgëzojmë për ardhjen e festës së Bajramit duke e lutur Allahun e Lartësuar që të na pranojë veprat e mira. Dëshirojmë që krahas gëzimit për ardhjen e kësaj feste, të njiheshit përmes këtij shkrimi me dispozitat, edukatën dhe sunetet e saj, duke shpresuar nga Allahu i Lartësuar që të jeni prej atyre që e duan Sunetin e të Dërguarit sal-Allahu alejhi ue sel-lem dhe i kundërshtojnë rrisitë në fe.

Festat e muslimanëve

Muslimanët kanë vetëm dy festa: festën e Fitër Bajramit dhe të Kurban Bajramit. Në sunenin e Ebu Davudit dhe të Nesaiut me zinxhir të saktë transmetohet nga Enesi, Allahu qoftë i kënaqur me të, se kur Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem erdhi në Medinë, i gjeti ata duke festuar dy festa dhe tha: *“Kanë qenë për ju dy ditë që keni lozur në to e Allahu i Lartësuar ua ka zëvendësuar me diçka më të mirë se ato: dita e Fitër Bajramit dhe e Kurban Bajramit.”*

Këto dy festa për muslimanët janë prej simboleve të Islamit, të cilat duhet të ngjallen, të njihet qëllimi i tyre dhe të dihet kuptimi i tyre.

Dispozitat e Bajramit dhe edukata e tij

1. Dispozita e namazit të Bajramit

Dijetarët kanë tre mendime rreth vendimit mbi namazin e bajramit, edhe atë:

- a) Është obligim për secilin musliman. Ky është mendimi i medhhebit Hanefi.
- b) Është sunnet i fortë. Ky është mendimi i Imam Malikut dhe shumicës së dijetarëve të medhhebit Shafii.
- c) Është obligim kolektiv, (farzi kifaje) nëse një grup e falin të tjerët lirohen. Ky është mendimi i Hanbelive, dhe disa dijetarëve të medhhebit Shafi.

Mendimi më i saktë për ne është mendimi i medhhebit hanefij, se namazi i bajramit është obligim (vaxhib).⁹⁰

Në dy librat e saktë transmetohet nga UmuAtija, Allahu qoftë i kënaqu me të, se ka thënë: “U urdhëruam që të dalim në dy Bajramet të moshuarat dhe ato

⁹⁰ Dijetari Abdul Aziz Ibën Bazi, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Namazi i Bajramit është farz kifaje (nëse një grup muslimanësh e falin, të tjerët lirohen nga falja e tij).” Ky është qëndrimi i shumicës së dijetarëve. Disa dijetarë kanë thënë se namazi i Bajramit është farz ajn (është obligim për çdo njeri) dhe ky mendim është më i qartë në argumente dhe më afër së vërtetës. Është sunet për gratë që të jenë të pranishme në të dy Bajramet duke pasur kujdes që të dalin të mbuluara mirë dhe duke iu larguar parfumimit.

që ishin me menstruacione për të dëshmuar mirësinë (begatinë) dhe lutjet e muslimanëve dhe (u urdhëruam) që të largohet ajo që ishte me menstruacione nga vendi i faljes.”

E në disa transmetime të tjera qëndron se ka thënë njëra prej tyre: “O i Dërguari i Allahut! Po nëse dikush prej nesh nuk gjen çfarë të veshë për të dalë (për faljen e namazit të Bajramin)?” Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem tha: *“Le të veshë xhilibabin e motrës së saj (mbulesën e saj).”* Dhe nuk ka dyshim se kjo argumenton për përforcimin e argumenteve për daljen e grave për namazin e Bajrameve që të dëshmojnë mirësinë (begatinë) dhe lutjet e muslimanëve. ⁹¹

2. Ndalimi i agjërimit në dy Bajramet

Ebij Sejdi ka transmetuar në të dy librat e saktë, se Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem e ka ndaluar agjërimin në dy ditë: në ditën e Fitër Bajramit dhe të Kurban Bajramit.

3. Tekbiri

Tekbiri bëhet kur bëhet plotësimi i muajit Ramazan prej perëndimit të diellit, natën e Bajramit, e deri në namaz të Bajramit. Allahu subhanehu ue teala thotë:

⁹¹ “Fetava etahare ve salat”, nga Abdulala Etajar-Ahmed ibn Baz.

وَلِتُكْمِلُوا الْعِدَّةَ وَلِتُكَبِّرُوا اللَّهَ عَلَىٰ مَا هَدَاكُمْ وَلَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ

"Që ta plotësoni numrin, të madhëroni Allahun për atë se ju udhëzoi abe që të falënderoni.⁹²

Mënyra e tekbirit siç ka ardhur nga të parët tanë të mirë:

Ali-llahu Ekber Ali-llahu Ekber Ali-llahu Ekber

La ilahe- ila llah

Ali-llahu Ekber Ali-llahu Ekber Ali-llahu Ekber

Ve lilahi Elhamd.

Ajo që duhet cekur dhe që është me rëndësi është se tekbiri duhet vazhduar derisa të hyjë imami. Muhamed bin Shihab Ezuhruj, Allahu e mëshiroftë, thoshte: "Njerëzit merrnin tekbire prej kur dilnin nga shtëpitë e tyre e deri sa hynte imami."

Është sunet për burrat që ta ngrenë zërin në xhami, në tregje, në shtëpi, për ta madhëruar Allahun e Lartësuar, për t'i bërë ibadet dhe për ta falënderuar Atë. Ndërsa gratë e ulin zërin, ngaqë ato janë të urdhëruara për t'u mbuluar dhe për ta ulur zërin. Çdo person bën tekbire vetë.

⁹² Kur'an, Bekare: 185.

4. Larja para se të dilet për namaz

Është saktësuar në “El Muvata” të Imam Malikut, Allahu e mëshiroftë, se Abdullah bin Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me ata të dy, lahej ditën e Fitër Bajramit para se të shkonte për t’u falur⁹³.

Nga Esaib bin Zejdi dhe nga Sejid bin Xhubejri, Allahu qoftë i kënaqur me ta, është transmetuar se kanë thënë: “Sunetet e Bajramit janë tre: ecja në këmbë, larja dhe ngrënia para daljes për në namaz.” Imam Neveviu, Allahu e mëshiroftë, ka përmendur se dijetarët kanë ranë dakord se është e pëlqyeshme larja për namazin e Bajramit.

5. Veshja e rrobave të bukura dhe përdorimi i parfumit

Transmetohet nga Xhabiri, Allahu qoftë i kënaqur me të, siç ka ardhur në “Sahihun e Ibën Huzejmës”, se ka thënë: “Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka pasur një xhybe (pallto), që e vishte në të dy Bajramet dhe në ditën e xhumasë.”

El Bejhakui ka transmetuar me zinxhir të saktë se Ibën Omeri vishte për Bajram rrobat më të bukura, ndërsa gruaja del për në namaz të Bajramit pa u zbukuruar dhe pa u parfumuar, duke qenë e mbuluar sipas normave islame.

⁹³ “El Muvata”, 1/177.

6. Ngrënia para se të dilet për në namaz të Bajramit Siç është përmendur në librin e saktë të Buhariut dhe të Ahmedit nga Enesi, Allahu qoftë i kënaqur me të, se ka thënë: *“Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk shkonte ditën e Fitër Bajramit pa ngrënë disa hurma dhe i hante ato tek: tre, pesë, shtatë ose nëntë.”*

Ndërsa në Kurban Bajram është e pëlqyeshme që të hahet vetëm pas namazit, në mënyrë që të hahet prej kurbanit që theret.

7. Dalja në këmbë për në namaz të Bajramit Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: “Prej sunetit është që të dilet për në namaz të Bajramit duke ecur, jo hipur (në mjet udhëtimi).”⁹⁴ Dhe prej sunetit është që të mos kthehet njeriu nga ajo rrugë që ka shkuar, por nga një rrugë tjetër.

8. Falja e namazit para hytbes

Ka ardhur në dy librat e saktë, prej hadithit të Ibën Omerit dhe të EbijSejdit dhe të Ibni Abasit, Allahu qoftë i kënaqur me ta, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është falur para hytbes.

Në librin e saktë të Imam Muslimit tregohet se është e pëlqyeshme të lexohet në rekatën e parë suretu Kaf

⁹⁴ E ka transmetuar El-Termidhiu dhe ka thënë: “Hadith është i mirë, i vërtetë.

dhe në rekatin e dytë fillimi i sures Enbija. Më së shumti është transmetuar se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem lexonte suret El A'ëla dhe El Gashije, siç transmetojnë Muslimi dhe Termidhiu.

9. Forma e namazit të Bajramit

Forma e namazit është dy rekate para hytbes duke argumentuar me thënien e Ibni Omerit: "Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, Ebu Bekri, Omeri dhe Othmani e falnin Bajramin para hytbes."⁹⁵

Në dy librat e saktë nga Ibni Abasi transmetohet se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka dalë ditën e Fitër Bajramit dhe ka falur dy rekate, duke mos falurasgjë para apo pas tyre. Kjo është për atë që falet jashtë në hapësirë, ndërsa ai që falet në xhami fal dy rekartet e hyrjes në xhami (tehijetulmesxid), duke argumentuar me fjalën e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: "*Nëse dikush nga ju hyn në xhami, mos të ulet derisa t'i falë dy rekate.*"⁹⁶

Nuk lejohet që të thirret ezani e as ikameti, siç ka transmetuar Muslimi nga Xhabiri: "Jam falur me Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem jo një herë e dy (por shumë herë). Ka filluar namazin para hytbes pa e thërritur ezanin dhe kiametin."

⁹⁵ Mutefekun alejhi.

⁹⁶ Mutefekun alejhi.

Forma e namazit

Namazi i Bajramit ka dy rekate dhe falet në këtë mënyrë:

Imami merr tekbirin fillestar e më pas edhe xhemati. Lidhen duarat për namaz dhe lexohet lutja (subhaneke), pastaj imami e më pas edhe xhemati e pason duke marrë edhe tre tekbir, që në gjuhën e fikhut islam quhen tekbiru-z-zevaid, duke i ngritur duart lart. Imami lexon suren El-Fatiha dhe një sure tjetër dhe është sunet të lexohet surja El-A'la. Shkohet në ruku dhe sexhde. Në rekatin e dytë imami lexon suren El-Fatiha e më pas një sure dhe preferohet të lexohet sureja El-Gashije dhe pastaj merren edhe tre tekbire të tjera të Bajramit, ngjashëm si në rekatin e parë, para se të shkohet në ruku. Me tekbirin e katërt shkohet në ruku e më pas në sexhde. Në fund lexohet et-tehijatu, salavatet dhe në fund jepet selam. Namazi i Bajramit falet para hutbes së Bajramit.

10. Shkuarja nga njëra rrugë dhe kthimi nga një rrugë tjetër

Është sunet për atë që shkon për të falur namazin e Bajramit që të kthehet nga një rrugë tjetër e jo nga ajo që ka shkuar, që ta pasojë Sunetin e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: “Pejgamberi sal-lAllahu

alejhi ue sel-lem, kur dilte ditën e Bajramit, e ndërronte rrugën.”⁹⁷

11. Prej urtësisë së Bajramit

Prej urtësisë së Bajramit në shariatit islam është që të shprehet gëzimi, kënaqësia dhe përgëzimi për plotësimin e ibadeteve si agjërimi, sadakaja (lëmosha), namazi, dhikri dhe që ta dinë armiqtë e Islamit se në fenë tonë ka pushim dhe gëzime. Po ashtu gëzohen fëmijët dhe gratë në këtë festë dhe arrihet lidhja mes muslimanëve.

12. Ki kujdes vëlla musliman!

Ki kujdes që të mos biesh në disa gabime si shumica e njerëzve, si për shembull kalimi i kohës me gjëra të ndaluara siç janë dëgjimi i muzikës, festimi në vendet e ndaluara ku përzihen burrat e gratë, veshja e grave me veshje që nuk u ka hije muslimaneve, duke pretenduar se është ditë feste e hareje dhe njeriu duhet ta shprehë këtë në forma të ndryshme.

13. Për kë është festa e Bajramit?

Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: “Sot është Bajram për atë që dje i është pranuar agjërimi

⁹⁷ E ka nxjerrë hadithin Imam Buhariu nga Xhabiri, Allahu qoftë i kënaqur me të.

dhe namazi i natës. Bajram është për atë që i janë falur mëkatet dhe i janë pranuar veprat. Sot për ne është Bajram, nesër për ne është Bajram dhe çdo ditë që nuk i bëjmë mëkat Allahut të Lartësuar për ne është Bajram.”

Vëlla!

Nuk është festa e Bajramit për atë që është veshur me rroba të mira, por për atë që i shtohen ibadetet; nuk është Bajrami për atë që është zbukuruar me veshje dhe mjete udhëtimi, por për atë nga i cili Allahu e ka larguar hidhërimin.

Dhe së fundi, mos harro vëlla që të veprosh vepra të mira: të mbash lidhjet dhe të vizitosh të afërmit dhe farefisin, ta harrosh hidhërimin, zilinë dhe urrejtjen kundër tyre dhe ta pastrosh zemrën nga këto sëmundje. Mos harro ndihmën për të varfrin dhe jetimin, mos harro t'i gëzosh kur njerëzit janë të gëzuar, kurse ata janë të mërëzitur e të hidhëruar.

Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të Dërguarin sal-Allahu alejhi ue sel-lem!

29. FETVA TË FIKHUT RRETH ÇËSHTJEVE BASHKËKOHORE MJEKËSORE TË RAMAZANIT

A e prish agjërimin dhurimi vullnetar i gjakut? Nëse i sëmuri ka nevojë për gjak, a i lejohet agjëruesit që t'i dhuroj gjak?

Përgjigjja: Po, nxjerrja e gjakut të shumtë për t'i dhënë të sëmurit në rast emergjence ose të dhuruarit gjak për raste të nevojshme e prish agjërimin pa dyshim, ngase hixhamja (një lloj nxjerrje e gjakut nga trupi i njeriut, nxjerrje e cila bëhet vetëm nën lëkurë) e prish agjërimin, sikurse ka ardhur në hadithin e saktë: "E prish (agjërimin) hixhambëresi dhe atij që i bëhet hixhamja", ngase nxjerrja e gjakut nga trupi i njeriut konsiderohet ushqim dhe forcë e tij dhe se nxjerrja e gjakut dhe agjërimi nuk mund të bashkohen sepse kjo është e dëmshme. Nxjerrja e gjakut të shumtë, qoftë nëpërmjet hixhames apo mjeteve mjekësore, e prish agjërimin. E nëse kjo është e domosdoshme, kur i sëmuri ka nevojë dhe mosdhënia e gjakut rrezikon jetën e tij, obligohet kush ka mundësi që t'i dhurojë gjak ngase është në rrezik jeta e një muslimani. Kjo është e njëjtë me shpëtimin e dikujt nga fundosja apo zjarri, prandaj ai detyrohet në këtë rast t'i lejojë mjekët që t'i marrin gjakun dhe do ta kompensojë këtë ditë sepse ai e ka prishur këtë ditë

agjërimi me arsye dhe do të shpërblehet për këtë ngase kjo llogaritet mirësi.

A e prishin agjërimin pikat e gjakut që merren për analiza? Po nëse kjo përsëritet më shumë se një herë në ditë?

Përgjigjja: Gjaku i paktë që nxirret për analiza nuk i përngjan hixhames, e cila është bazë në këtë çështje (d.m.th. nuk e prish agjërimin).

Nëse ndodh që i sëmuri ka gjakderdhje duke qenë agjërueshëm, a e prish agjërimin në këtë rast, pa marrë parasysh se i shumë apo i paktë është ky gjak?

Përgjigjja: Gjakderdhja pa dashje shumë apo pak nuk ndikon tek agjëruesi (që t`ia prishë agjërimin), pasi kjo ndodh pa qëllimin e agjëruesit. Kjo është e njëjtë sikur të lëndohet diku apo pas nxjerrjes së dhëmbit ka gjakderdhje dhe është e njëjtë se është bërë pa dashjen e tij. Agjërimi priset kur bëhet nxjerrja e gjakut me vetëdashje, si p.sh. hixhamja apo të dhuruarit e gjakut.

A e prishin agjërimin injeksionet me përmbajtje vitamini-nash? Disa injeksione kanë në vetvete përbërje vitamini-nash të cilat fuqizojnë sistemin nervor, por nuk ndikojnë në fuqizimin e trupit. Cila është përgjigjja juaj?

Përgjigjja: Injeksioni që përmban vitamina konsiderohet ushqyes dhe kjo ndikon tek agjëruesi dhe nuk lejohet që ta përdorë duke qenë agjërueshëm. Në rastet

kur ka nevojë për të, e përdor atë dhe e kompenson atë ditë ngase injeksionet e tilla e prishin agjërimin.

A e prishin agjërimin injeksionet intravenoze apo intramuskulare? Disa injeksione intravenoze (që jepen në vena) apo intramuskulare (në muskuj), të cilat i japin të sëmurit një lloj fuqizimi në trup, a llogariten se janë ushqyese dhe a prishet agjërimi?

Përgjigja: Për injeksionet që i jepen agjëruetit është folur mjaftdhe është konstatuar se injeksioni ushqyese e prish agjërimin, pa kurrfarë diskutimi, pasi zëvendëson ushqimin dhe pijen, prandaj e prish agjërimin. Ndërsa injeksionet intravenoze, por që nuk janë ushqyese, të cilat merren nëpërmjet venave, janë çështje diskutimi mes dietetarëve bashkëkohorë. Disa thonë se e prishin agjërimin ngase përzihen me gjakun dhe ecin nëpër trup dhe i japin fuqizim trupit. Ndërsa të tjerët thonë nuk e prishin agjërimin ngase nuk janë ushqyese dhe nuk ndikojnë në prishjen e agjërimit.

Ndërsa për injeksionet intramuskulare që jepen në muskuj dhe që nuk janë ushqyese nuk ka problem ngase nuk ndikojnë tek agjërueti meqë nuk depërtojnë në gjak apo në brendësi të trupit, por janë vetëm nën lëkurë. Injeksionet intramuskulare që jepen në muskuj (nën lëkurë) nuk e prishin agjërimin.

A lejohet të përdoren kur sëmundja nuk është e rrezikshme? Disa barna kanë kohë të caktuar përdorimi

sepse nëse përdoren jashtë kësaj kohe, ato e humbin efektin e tyre ndikues tek i sëmuri. A lejohet të përdoren kur sëmundja për shkak të së cilës merret ilaçi mund të jetë sëmundje e rëndomtë e jo diçka e rrezikshme?

Përgjigja: Po, lejohet të përdoren duke qenë agjërueshëm (duke e ndërprerë agjërimin), nëse barnat kanë kohën e vet të caktuar të përdorimit, sepse nëse nuk përdoren në kohën e caktuar, humb efekti i tyre. P.sh.: gjatë ditës së Ramazanit nëse nuk i përdor, humb efektin e vet dhe i sëmuri ka nevojë për të, sikurse thotë Allahu azeuexhel: "Ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme." Ky person e përdor ilaçin dhe e kompenzon atë ditë pas Ramazanit, pasi ai është i sëmurë dhe hyn në fjalën e Allahut: "Ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme." Edhe nëse sëmundja nuk është shumë e rëndë ose e rrezikshme, Allahu azeuexhel e ka lejuar ilaçin dhe e ka lejuar të sëmurin që të hajë nëse agjërimi shkakton dobësim ose ndikon tek ai. Ndërsa sëmundja e rëndomtë sikurse dhimbja e kokës apo e dhëmbit nuk është arsye që të mos agjërojë dhe nuk i lejohet që ta prishë agjërimin.

Jemi të sigurt se ky vonim nuk i bën dëm të sëmurit.

Disa të sëmurë kanë nevojë për operacione të lehta, të cilat nuk i bëjnë dëm të sëmurit po t'i shtyjë pas muajit Ramazan, por disa të sëmurë e refuzojnë një gjë të tillë.

Si është puna në këtë gjendje, kur ata e refuzojnë një gjë të tillë, sepse ne mjekët jemi të sigurt se ky vonim nuk i bën dëm të sëmurit.

Përgjigjja: Kjo është më mirë të shtyhet pas Ramazanit, pasi vonimi i tillë nuk i sjell të sëmurit ndonjë dëm sepse çështja është e njëjtë në Ramazan apo jashtë Ramazanit, kjo është më e mirë dhe më e dobishme që ta vonojë deri pas Ramazanit.

A i ndalohet mjekut që ta kryejë operacionin e tillë gjatë ditëve të Ramazanit? Nëse operacioni nuk është emergjent dhe mund të vonohet deri pas Ramazanit, a i ndalohet mjekut që ta kryejë operacionin e tillë gjatë ditëve të Ramazanit?

Përgjigjja: Kjo është sikurse e cekëm më parë. Është më mirë dhe më e dobishme të vonohet deri pas Ramazanit, porse nëse i sëmuri e kërkon një gjë të tillë, mjeku e kryen duke iu përgjigjur dëshirës së të sëmurit. Ndërsa sa i përket mjekut, nuk ka ndonjë gjë për të, porse duhet që ta këshillojë të sëmurin dhe ta lajmërojë se kryerja e saj në Ramazan nuk është e domosdoshme.

Ç'thoni ju për këtë?

Disa të sëmurë në rast se ua lejon ta prishin agjërimin -Allahu na ruajt:- përdorin duhan, ç'thoni ju për këtë?

Përgjigjja: Duhani është i ndaluar (haram), nuk lejohet as për të sëmurin as për të shëndoshin, qoftë

gjatë Ramazanit apo jashtë tij. Një gjë të tillë e dinë edhe mjekët. Personi i tillë duhet të këshillohet që mos ta sëmurë veten edhe me një sëmundje tjetër krahas asaj që ka. Të këshillohet, t'i bëhet i qartë rreziku dhe t'i ketë frikën Allahut dhe të mjaftohet me atë që Allahu ka lejuar.

A e prishin agjërimin pikat që hidhen në sy?

Përgjigja: Është objekt diskutimi mes dijetarëve duke u bazuar tek syri a është syri grykë qarkullimi, i cili përcjell për në brendësi të trupit apo nuk është grykë qarkullimi? Ka prej tyre që e lejojnë dhe thonë se syri nuk është grykë qarkullimi dhe ka prej tyre që thonë se syri është grykë qarkullimi përcjellës, me argumentin se nëse e vendos një pikë në sy, e ndien shijen e saj në fyt. Ky është argumenti i tyre që syri është grykë qarkullimi dhe duke u bazuar në këtë thonë se e prish agjërimin. Çështja është dilemë mes dijetarëve dhe në këto çështje muslimani obligohet t'i largohet asaj ku ka dilemë dhe të dilet nga kjo duke marrë rezervat, ngase pikat nuk janë të detyrueshme, por nëse janë të detyrueshme patjetër gjatë ditës së Ramazanit e merr duke pasur kujdes që mos t'i shkojë në brendësi të trupit. Nëse e ndien shijen e saj, të mundohet që ta kthejë dhe ta ndërpresë kalimin e saj në fyt. Kjo veprohet nëse e ka të domosdoshme, e nëse jo, e vonon përdorimin e saj deri në mbrëmje.

Pastrimi i veshkave për agjëruesin e sëmurë që është i varur nga pastrimi i veshkave (dializa) është gjithmonë i lidhur me terapinë për pastrimin e veshkave dhe i sëmuri që është agjërueshëm a e prish agjërimin?

Përgjigjja: Pastrimine veshkave e shoqëron uji, i cili depërton në brendësi të trupit dhe tërheq materie. Kjo e prish agjërimin. Për këtë ka dalë edhe fetva nga Komisioni i Përhershëm për Fetva në Arabinë Saudite, në Riad, se pastrimi i veshkave e prish agjërimin, pasi e shoqëron uji dhe materie që futen në fytyrën e agjëruesit dhe nxirren.

A obligohet ta kompensojë këtë ditë?

Ai që e humb vetëdijen gjatë ditës së Ramazanit, a obligohet ta kompensojë këtë ditë?

Përgjigjja: Po, ai që e humb vetëdijen një, dy apo tri ditë, i kompenson, se në kompensimin e tij nuk ka mundim (ka mundësi), pasi disa nga sahabët kanë humbur vetëdijen tri ditë dhe e kanë kompensuar namazin. Kjo është periudhë e lehtë, nuk është e mundshme dhe ka mundësi për kompensim.

Cila është dispozita e agjërimit për këta njerëz?

Disa të sëmurë goditen me gjakderdhje në kokë ose me sëmundje të tjera, të cilat bëhen shkaktare që ai të qëndrojë në shtrat dhe ta humbë vetëdijen në përgjithësi për vite të tëra. Cila është dispozita e agjërimit për këta

njerëz ahe si duhet të kompensohet apo të jepet ushqim për të?

Përgjigjja: Nëse e ka humbur vetëdijen me vite, ai është i liruar pasi nuk është i ngarkuar (me obligimet e sheriatit) gjatë kësaj gjendjeje. Pejgamberi (sal-lallahu alejhi ue sel-lem) ka thënë: "Është ngritur lapsi nga tre persona: nga fëmija derisa të hyjë në moshën madhore, nga i çmenduri derisa t'i vijë vetëdija, nga ai që është në gjumë derisa të zgjohet." Kjo është për atë që nuk është në gjendje të logjikojë. Atë që e ka goditur gjakderdhja dhe e ka humbur vetëdijen në përgjithësi ka edhe më të drejtë është i liruar gjatë kohës kur nuk ka vetëdije. Porse nëse e shëron Allahu dhe i kthehet shëndeti dhe vetëdija, ai duhet të agjërojë dhe të falet në të ardhmen, ndërsa ajo që ka kaluar gjatë gjendjes së humbjes së vetëdijes Allahu ia ka falur, pasi nuk ka qenë i ngarkuar.

A e prish agjërimin laparaskopia? Shpresoj të na shpjegoni llojet dhe venapërdorimin e tyre.

Përgjigjja: Për laparaskopinë është pyetur Komisioni i Përhershëm për Fetva dhe na ka ardhur nga mjekët një raport për të, ku është konstatuar se përdorimi i tij e prish agjërimin pasi ato futen përmes fytit dhe shoqërohet nga materie mjekësore dhe barna si dhe një sasi uji. Pra, e prish agjërimin.

A i lejohet shtatzënës apo gjdhënësës ta prishë agjërimin? A i lejohet gruas që vetëm për shkak të shtatzënisë apo gjdhënies ta prishë agjërimin? Kërkojmë nga ju që të na tregoni gjërat që e prishin agjërimin.

Përgjigjja: Po, nëse agjërimi i bën dëm shtatzënës apo foshnjës së saj, ose gjdhënësës dhe foshnjës së saj, lejohet ta prishë agjërimin për ta mbrojtur veten dhe foshnjën nga dëmi i tillë dhe ditët e mbetura (që nuk i ka agjëruar) t'i kompensojë. Ky është mendimi i shumë sahabëve (radijAllahu anhum), pasi llogaritet arsyetim që lejon prishjen e agjërimit për të mbrojtur grua ja veten dhe foshnjën e saj.

Gjërat që e prishin agjërimin ndahen në dy grupe:

1. Gjërat që depërtojnë në brendësi të trupit, si ushqimi, pija, ilaçet ose injeksionet ushqyese. Këto gjëra e prishin agjërimin.
2. Gjërat dalëse nga brendësia e trupit, si gjaku i menstruacioneve, lehonës, marrëdhënie intime, pasi është dalës nga trupi me hedhjen e spermës.

Disa femra përdorin barna për ndalimin e menstruacioneve, me qëllim që ta agjërojnë muajin e Ramazanit të gjithë. A lejohet një gjë e tillë?

Përgjigjja: Nëse mjekët thonë se një gjë e tillë nuk e dëmton shëndetin, nuk ka problem të përdoren për shkak që të agjërohet Ramazani pa e ndërprerje.

A e prish agjërimin thithja e ilaçit të sëmundjes së astmës me anë të pompës?

Përgjigja: Unë kam problem në këtë çështje, por Komisioni i Përhershëm për Fetva ka thënë fetva se kjo lejohet, pasi përdorimi i pompës së astmës nuk përmban ndonjë materie që ndikon apo depërton në brendësi të trupit, por ajo është vetëm një mjet ndihmues që përmban ajër. Kjo fetva ka dalë me shkrim nga dijetari Abdulaziz Ibn Baz (Allahu e mëshiroftë) si dhe anëtarë të tjerë të komisionit⁹⁸.

⁹⁸ Marrë nga libri “Fetva të fikhut rreth çështjeve mjekësore të Ramazanit”, nga dijetari i njohur shejh Salih el Fezvani, përkthyer nga Rashit Zylfiu.

30. DOBITË SHPIRTËRORE DHE SHËNDETËSORE TË AGJËRIMIT⁹⁹

Allahu i Madhërishëm në Kur'anin Fisnik urdhëron e thotë:

“O ju që keni besuar, agjërimi u është bërë obligim ashtu siç u qe bërë obligim atyre që ishin para jush ashtu që të bëheni të devotshëm.”

(Kur'an, Bekare:183)

Dobitë mjekësore të Ramazanit

“Agjërimi është Imi dhe Unë jam ai që jep shpërblimin për të. Agjëruesi i lë marrëdhëniet intime, ushqimin dhe pirjen për Mua. Agjërimi është mburojë, e ai që agjëron ka dy gëzime: kur ha iftarin dhe kur takohet me Zotin e vet.”

Transmetohet se Muhamedi alejhi selam ka thënë: *“Sikur ta dinin besimtarët e umetit tim se çfarë dobie ka në Ramazan, do të dëshironin që tërë viti të jetë Ramazan.”*

Muslimanët nuk e agjërojnë muajin e Ramazanit për shkak të dobive shëndetësore që sjell agjërimi. Agjërimi si metodë është mbajtur nga pacientë të

⁹⁹ Punuar nga Dr. Kushtrim Qerimi & Dr.Majlinda Esati-Qerimi, Rems Murr Klinikum Winnenden, Gjermani.

ndryshëm për të kontrolluar peshën e trupit, për të qetësuar sistemin tretës dhe për të ulur sasinë e lipideve. Megjithatë agjërimi i plotë (agjërimi jo islam) dhe dietat e varfra ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut, ndërkohë që agjërimi islam është i ndryshëm nga dieta të tilla sepse gjatë Ramazanit nuk ka kalori apo ushqim të papërshtatshëm që hyn në organizmin e njeriut. Kaloritë që muslimani merr gjatë Ramazanit janë në të njëjtin nivel apo qëndrojnë pak më poshtë standardit të vlerave ushqyese. Përveç kësaj, agjërimi gjatë Ramazanit është një vepër që kryhet me vullnet të lirë dhe jo një recetë e imponuar nga mjeku. Ramazani është muaji i vetëkontrollit dhe përmirësimit të vetvetes, me shpresë se një regjim i tillë nuk do të përfundojë me përfundimin e Ramazanit. Nëse mësimeve që mësojmë gjatë Ramazanit, qoftë në vija dietike apo të devotshmërisë, u përmbahemi edhe pas Ramazanit, ndikimet do të jenë vërtet afatgjata. Për më tepër, lloji i ushqimit që konsumohet gjatë agjërimit nuk karakterizohet nga kritere përzgjedhëse si ai i dietave të mangëta, si për shembull tipi i atyre të pasura thjesht në proteina apo vitamina. Çdo gjë që është e lejuar lejohet të konsumohet, por me maturi. Ndryshimi mes Ramazanit dhe agjërimit të plotë qëndron tek përcaktimi i kohëve të ushqimit; në Ramazan ajo që humbim është dreka, ndërsa mëngjesin e hamë pak më herët dhe nuk hamë më pas, derisa dielli të perëndojë. *Moskonsumimi i ujit për afro 8-10*

orë nuk është i dëmshëm për shëndetin, i cili në fakt mundëson koncentrimin e të gjitha lëngjeve brenda organizmit, duke prodhuar një dehidratim të lehtë. Trupi i njeriut zotëron një mekanizëm që rezervon ujë; në fakt është vërtetuar se dehidratimi i lehtë dhe uji i rezervuar, së paku në botën bimore, shtojnë jetëgjatësinë.

Ndër efektet fiziologjike të agjërimit mund të përmendim uljen e sasisë së sheqerit në gjak, uljen e kolesterolit dhe të trysnisë sistolike (shtypjes) të gjakut. Në të vërtetë, agjërimi i Ramazanit do të ishte një rekomandim ideal për diabetikët e mesëm (të sëmurët me sëmundjen e sheqerit, të cilët marrin tableta kundër sëmundjes së sheqerit), të qëndrueshëm dhe të atyre me mungesë të plotë insuline, për obezët dhe për njerëzit me hipertension. *Në vitin 1994, Kongresi i Parë Ndërkombëtar mbi "Shëndetin dhe Ramazanin" i zhvilluar në Kazablanka, paraqiti 50 studime të thukëta për etiketmedicinale të agjërimit.* Ndërkohë që ishin vënë re përmirësime në shumë aspekte mjekësore, u vu re po ashtu se agjërimi nuk e dëmtonte aspak shëndetin e pacientit apo ecurinë e kurës mjekësore. Në anën tjetër, pacientët që vuajnë nga sëmundje të rënda, si diabeti i shkallës I (mungesë totale e insulinës qysh në fëmijëri), sëmundje të arterieve të zemrës, gurët në veshka etj., përjashtohen nga agjërimi dhe nuk u lejohet të agjërojnë.

*Agjërimi është ilaçi më i mirë – mjeku i brendshëm.
- Paracelsus, mjek i shekullit 15*

Hipokrati, Aristoteli, Galen Paracelsus, Platoni, Sokrati dhe shumë filozofë të mëdhenj, shkencëtarë dhe mjekë, gjithashtu edhe Profetët për shekuj me radhë e kanë përdorur agjërimin si metodë të pastroimit, shërimit dhe rigjallërimit të trupit, fizikisht dhe spiritualisht.

Sigurisht që edhe më parë keni dëgjuar që agjërimi është një mënyrë shumë e mirë për humbje peshe, por përveç humbjes së peshës agjërimi ka edhe shumë të mira të tjera shëndetësore. Përveç të tjerash, agjërimi nuk duhet të mendohet se u takon atyre që janë besimtarë. Agjërimi mund të bëhet kurdoherë pa pasur arsye të jesh besimtar. Kjo domethënë se agjërimi si sistem më vete, nëse aplikohet në formë islame, ka ndikim të jashtëzakonshëm tek njeriu pavarësisht qëllimeve të agjëruarit, qofshin ato prej bindjeve fetare apo arsyeve të tjera. Në këtë shkrim mund të mësoni për shumë të mira të tjera shëndetësore që agjërimi ju sjell.

1. Agjërimi është më i lehtë se cilado dietë dhe mënyra më e shpejtë e humbjes së peshës.
2. Agjërimi është i adaptueshëm në jetë të zënë me ngarkesa. I jep trupit pushim fiziologjik.
3. Agjërimi përdoret me sukses në shërimin e shumë sëmundjeve të ndryshme.

4. Agjërimi mund t'ju ofrojë humbje të peshës deri në 5 kg në javën e parë.
5. Agjërimi ul dhe normalizon kolesterolin, homocisteinën dhe shtypjen e gjakut.
6. Agjërimi është një përjetim qetësues shpesh duke qetësuar tensionin (shtypjen e gjakut) dhe insomninë (pagjumësinë).
7. Agjërimi përmirëson veset dietale dhe ngre kënaqësinë e ngrënies (e shton apetitin).
8. Agjërimi është rigjallërues (në regjenerimin e qelizave të vjetra) dhe zvogëlon procesin e plakjes.
9. Agjërimi është stimulant për rigjallërimin e rritjes së niveleve të hormoneve.
10. Agjërimi jep energji dhe ndihmon në procesin e eliminimit të materieve të dëmshme.
11. Agjërimi është përmirësues i jetës seksuale.
12. Agjërimi mund të eliminojë apo modifikojë pirjen e duhanit dhe fiksimin ndaj alkoolit.
13. Agjërimi është rregullator sepse edukon trupin që të konsumojë ushqim vetëm sa i duhet.
14. Agjërimi nxjerr nga trupi toksinat duke i dhënë atij një pastrim të brendshëm.
15. Agjërimi nuk privon trupin nga materiet esenciale ushqyese.
16. Agjërimi mund të përdoret për të zbuluar burimin e alergjive nga ushqimet.
17. Agjërimi me sukses përdoret në mjekimin e skizofrenisë dhe sëmundjeve të tjera mentale.

18. Agjërimi nën mbikëqyrje të duhur mund të tolerohet deri në 4 javë (fakt shkencor-studim shkencor jo fetar).
19. Agjërimi nuk akumulon apetitin; dëshira për të ngrënë zhduket pas 1 deri 2 ditëve.
20. Agjërimi është rutinë në mbretërinë e kafshëve.
21. Agjërimi ka qenë praktikë e zakonshme qysh nga zanafilla e ekzistencës së njeriut.
22. Agjërimi është rit fetar që përdoret edhe tek fetë e tjera.
23. Agjërimi është mjekimi natyror që Zoti na e ka dhënë.

Agjërimi duhet të aplikohet edhe jashtë Ramazanit. Ja se çfarë rekomandojnë mjekët bashkëkohorë, të cilët merren ekskluzivisht vetëm me dietat-agjërimin. Ata thonë se së paku një ditë në javë zgjidhe dhe agjëro. Atë ditë mos ha asgjë për 24 orë dhe pi vetëm ujë ose ndonjë lëng portokalli apo karote. Mos pi duhan dhe alkool dhe lëri që të dyja, as kafe mos pi. Uji dhe lëngu që zgjedh të pish ndihmojnë trupin që të nxjerrë jashtë toksinat që janë mbledhur në trup. Kështu trupi ka më pak toksina dhe përfundimisht ju jeni më i shëndetshëm.

Siç po e shihni, *agjërimi* është i dobishëm për shëndetin e të gjithëve dhe nuk duhet konsideruar vetëm si diçka që bëhet vetëm nga religjiozët thonë mjekët bashkëkohorë.

“Agjëroni që të jeni të shëndetshëm” Hadith. Agjërimi është një vepër që ka shumë dobi si nga ana shpirtërore ashtu edhe nga ana shëndetësore...

- Agjërimi përmban në vetvete cilësi antiplateletale dhe mbron nga përhapja e trombeve (trombet janë shkaktare të pikës në zemër ose në tru).

- Agjërimi ka efekt stabilizues tek membrana qelizore duke vepruar në marrëdhënien e kaliumit dhe kalciumit në nivelin membranor. Për këtë ai mbron nga disritmitë e zemrës dhe trurit (çrregullimet e ritmit të zemrës dhe të trurit).

- Agjërimi përmes efekteve të magnezit parapengon formimin e ateromeve (pllakëzat e yndyrës të cilat krijohen në enët e gjakut) dhe zberthen këto pllakëza, të cilat janë përgjegjëse për sulme në zemër dhe tru.

- Magnezi rrit aktivitetin fibrinolitik të gjakut, i cili udhëheq drejt prevenimit dhe krijimit të koagulëve të rinj.

Gjatë agjërimit tajimi i hormoneve të gjëndrës hipofizare rritet sepse ekziston hormoni anabolik për sintezën e proteinave dhe kolagjenit, i cili prodhon baraspeshën pozitive të azotit. Ai gjithashtu stimulon eritropozën (formimin e gjakut të ri në organizëm) dhe sintezën e kolagjenit.

Gjatë agjërimit, namazit dhe përvojave të ndryshme shpirtërore në Ramazan disa substanca të caktuara endogjene përmes trurit lirohen në organizëm. Këto

substancia quhen opoide (kundër lodhjes dhe dhembjeve të ngjashme me medikamentet që përdoren në mjekësi). Këto përfshijnë eukefalinën dhe endorfinën, që janë përgjegjëse për eufori, qetësi, disponim dhe çiltëri gjatë kësaj periudhe. Beta-endorfinët janë më aktivët. Këta janë 20 herë më të fuqishëm se morfina. Këta përveçse eliminojnë dhembjen, shkaktojnë ndjenjën e fortë të euforisë.

Gjatë agjërimit arrihet rikalibrimi enzimatik.

Organizmi shton ndryshimet enzimatike që ndikojnë në rregullimin e shumë sistemeve si detoksifikimi nga substancat helmuese, shpenzimi i rezervave dhjamore dhe rezervimin e proteinave. Ky është edhe shkak i përmirësimit të gjendjeve klinike të pacientëve.

Atmosfera shpirtërore gjatë agjërimit ul stresin. Stresi ndikon në kualitetin e jetës dhe është shkak potencial për shumë sëmundje.

Agjërimi lehtëson dhe mobilizon eliminimin e substancave të dëmshme nga organizmi, si kolesterolin, acidi urik, dioksina dhe mbetje të tjera toksike.

Agjërimi ka një ndikim normalizues në sistemin autonom nervor, ul shqetësimet në sistemin digjestiv (tretës) si dhe qetëson gjendjen e ankthit.

Agjërimi përbën një periudhë pushimi për organet e sistemit tretës dhe zemrës:

- Mëlçia (laboratori qendror i organizmit) pushon 4-6 orë.
- Zemra gjatë ditës rrah 14.000 herë më pak.

- Veshkat gjatë agjërimit pushojnë dhe ripërtërihen.
- Zorrët kanë një periudhë pushimi dhe ulet ritmi i punës së tyre.

Agjërimi ka efekt stabilizues edhe te diabetikët, sepse ngre nivelin e insulinës. Po ashtu efekt evident agjërimit ka edhe te sëmundja e Alz'heimerit (demencë e hershme e trurit), pa dyshim si pasojë e efektit detoksifikues të agjërimit në sistemin nervor.

Agjërimi është sekret i jetëgjatësisë. Po ashtu ka efekt antikancerogjen.

Agjërimi ndihmon në lehtësimin e sëmundjeve si *artriti, koliti, astma, alergjitë e ndryshme dhe largon lodhjen.*

Kokëdhembja që paraqitet në ditët e para të Ramazanit veçanërisht te konsumuesit e kafesë dhe duhanit gjithashtu shoqërohet me humbje të gjumit dhe me ndjenjën e urisë. *Këtyre personave u këshillohet që të fillojnë t'i lënë kafënë dhe duhanin dalëngadalë qysh para një ose dy javë para Ramazanit.*

Vendin e kafesë duhet ta zënë pije pa kafeinë, si bli, çaj mali dhe pije joalkoolike.

Niveli i ulët i sheqerit në gjak (hipoglicemi) shoqërohet me dobësi, marramendje, lodhje, dobësi në përqendrim, djersitje e shpejtë, dridhje (tremor), paaftësi për veprimtari fizike, kokëdhembje, rrahje zemre e fortë.

Si shkak është marrja e bollshme e sheqerit veçanërisht në syfyr në formën e karbohidrateve të rafinuara. Si

përgjigje, trupi sekreton shumë insulinë, gjë që shkakton rënien e nivelit të sheqerit në gjak.

Agjërimi gjatë një muaji ndikon në harxhimin e dhjamërave të depozituara gjatë 11 muajve dhe ndihmon në rënien nga pesha.

Dr. Alexis Carrel (fitues i çmimit Nobel në mjekësi - 1940), në librin e tij "L'homme, cetinconu" (Njeriu, ky i panjohur) thotë: "Gjatë agjërimit harxhohen dhjamërat dhe lëndët e tepërta të depozituara në trup, e më pas këto zëvendësohen me të reja, kështu ndodh një ripërtëritje në trup."

Dobitë psikologjike të agjërimit.

Gjatë agjërimit trupi ka një periudhë pushimi të plotë nga e cila përfiton në mënyrë të shpejtë.

Neuroadoptimi: Agjërimi ndihmon sensorët e shijes që të përshtatet me një nivel më të ulët të kripës që merret në ushqim. Kjo gjë i mundëson trupit të adoptohet me shpejtësi me një dietë të shëndetshme me më pak kripë.

Rikalibrimi enzimatik: Gjatë agjërimit, trupi shton ndryshimet enzimatike që ndikojnë në rregullimin e

shumë sistemeve si detoksifikimi nga substancat helmuese, harxhimin e rezervave dhjamore dhe rezervimin e proteinave. Ky është dhe shkaku i përmirësimeve në gjendjen klinike të pacientëve.

Humbja në peshë: Nuk është një strategji primare për rënien nga pesha, por ndihmon. Ndhmon në fitimin e zakoneve të një ngrënieje të rregullt. Meqenëse reduktohet prija e duhanit, pastrohet gjaku dhe forcohen mushkëritë.

Stresi: Atmosfera shpirtërore gjatë agjërimit ul stresin. Stresi ndikon në cilësinë e jetës dhe është shkak potencial për shumë sëmundje. Organizmi i obezëve gjen mundësinë e pushimit si dhe i jepet mundësia që të rregullojë mënyrën e të ushqyerit.

Detoksifikimi: Agjërimi lehtëson dhe mobilizon eliminimin e substancave të dëmshme nga organizmi, si kolesterolit, acidi urik, dioksina dhe mbetje të tjera toksike.

Natriureuzis: Agjërimi nxit efektin natriuretik, që e lejon trupin të eliminojë natriumin dhe ujin e tepërt nga organizmi. Kjo lejon zgjidhjen e problemeve kronike me edem dhe ndihmon në uljen e volumit të rritur të gjakut, bashkë me presionin e lartë të gjakut. Agjërimi ndihmon në lehtësimin e sëmundjeve si

artriti, koliti, astma, alergjitë e ndryshme dhe largon lodhjen duke ulur kalimin e pjesëzave të vogla të patretura mirë nga zorrët në enët e gjakut. Agjërimi ka një ndikim normalizues në sistemin autonom nervor. Ul shqetësimet në sistemin tretës si dhe qetëson gjendjen e ankthit. Agjërimi përbën një periudhë pushimi për organet e sistemin tretës:

- Zorrët kanë një periudhë pushimi për sa i përket sekrecionit të lëngjeve si dhe ulet ritmi i punës së muskujve. Pllakat Peyer, që ndodhen në zorrë, nën endodermë, janë pjesë e sistemit mbrojtës. Gjatë agjërimit bëhet revizionimi mbi to dhe njeriu bëhet më i qëndrueshëm ndaj sëmundjeve që kalojnë në sistemin tretës.

- Mosdjegia e plotë e mbeturinave të lëndëve ushqimore në enët e gjakut shkakton dëmtimin dhe konsumimin e tyre, kurse gjatë agjërimit, sidomos para iftarit, të gjitha lëndët ushqimore në gjak eliminohen.

- Palca: Gjatë agjërimit palca e kockave (vendi ku prodhohet gjaku) ngacmohet dhe shtohet sasia e prodhuar e gjakut.

- Dukuria që i prek shumë qelizat: Rregullimi i ekuilibrit të ujit mes qelizave si dhe brenda tyre. Gjatë

agjërimin kjo zbrit në minimum dhe kështu në funksionet qelizore ndodh një qetësim i rëndësishëm.

- Agjërimi dhe hipertensioni: Hipertensioni është shkaktari kryesor që kontribuon në vdekjet dhe dëmtimet në shoqëritë e industrializuara. Në vitin 1984, qendra shëndetësore "Tru North Health Center" në USA bëri një studim me 174 pacientë mbi hipertensionin. *Kurimi ishte qëndrimi pa ngrënë, vetëm duke pirë ujë. 90% e pacientëve u shëruan plotësisht e nuk patën më nevojë për ilaçe.*

-Agjërimi dhe sëmundja Alz'heimer: Në një eksperiment të bërë me tre grupe kaviesh, një grup u la pa ngrënë, një grup me dietë të rreptë dhe i treti u la të hante sipas dëshirës. Tek grupet që u lanë pa ngrënë dhe ata që ishin me dietë të rreptë përqendrimi i sheqerit dhe i insulinës ishte më i ulët krahasuar me kaviet që ishin të lira të hanin sipas dëshirës. Të tre grupeve iu injektua lënda toksike që dëmtonte qelizat e trurit dhe si pasojë shkaktohej sëmundja Alz'heimer. Rezultati: Qelizat e trurit në kaviet që u lanë pa ngrënë u dëmtuan më pak se ato të kavieve me dietë apo të ushqyer normalisht.

- Agjërimi dhe tërheqja hënore: Largimi i Hënës nga Toka siç ndikon mbi detet dhe oqeanet po ashtu ndikon dhe mbi trupin e njeriut, që mbi 70% ka ujë. Agjërimi ndihmon në ruajtjen e ekuilibrit mendor dhe

trupor si dhe stabilizon efektet e tërheqjes hënore mbi organizëm.

Rekomandohet agjërimi i ditës së 13-të, 14-të dhe 15-të sipas kalendarit hënor, pasi janë ditët kur rritet në maksimum tërheqja hënore dhe efektet e saj negative mbi organizëm.

Agjërimi sekret i jetëgjatësisë

"Po ta dini, agjërimi është më i dobishëm për ju."

Trupi dhe organet e sistemit tretës duhet të punojnë vazhdimisht, pa pushim. Të gjithë e dimë se pas një pune të lodhshme nevojitet një periudhë pushimi dhe ky është muaji i Ramazanit. Gjatë Ramazanit eliminohen toksinat (helmet) nga trupi. Agjërimi është shërim për sëmundjet. Dr. Dewey, Dr. Guelpa, Dr. Frumusan, Dr. Pauchet janë disa nga mjekët që kanë kryer kërkime mbi agjërimin dhe e kanë përdorur agjërimin me kohë të gjata dhe të shkurtra për trajtimin e pacientëve të tyre.

Dr. Dewey i këshillon pacientët e vet dhe njerëzit e shëndetshëm: "Hani dy vakte në ditë."

Dr. Pauchet i këshillon pacientët që do të operohen, që të agjërojnë para dhe pas operacionit, për të ulur në minimum rreziqet e operacionit dhe që të shpejtojnë mbylljen e plagës.

Ndryshimi mes agjërimit dhe ndenjes pa ngrënë. Kur rri pa ngrënë stomaku është në pritje të ushqimit

dhe sekreton acid vazhdimisht, gjë që është e dëmshme. Personi që agjëron e di që nuk do të hajë deri në iftar dhe truri nuk nxit sekrecionet e stomakut. Shumica e sëmundjeve që prekin njeriun janë pasojë e stomakut të tyre që e ngarkojnë me çdo gjë që u pëlqen apo jo, pa dallim se çfarë u nevojitet. Me këtë po përputhemi me fjalën e Muhamedit, Pejgamberit tonë alejhi selam, që thoshte: “*Nuk mbush njeriu ndonjë enë më të dëmshme se stomakun e tij.*” Nëse stomaku është qendra e belave, në të njëjtën kohë kur lukthi është vendshërim, atëherë të përmbajturit (agjërimi nga ushqimi) është ilaçi themelor. Në një revistë është thënë se “300 njerëz u shëruan nga sëmundja e sheqerit me anë të agjërimit”.

Më lejoni të përmend disa fjalë të mjekëve me famë botërore rreth agjërimit.

Dr. Ridli është i njohur për shërimin e pacientëve me anë të agjërimit dhe e ka quajtur agjërimin “*operacion pa thikë*”. “Si çdo makinë, ashtu edhe organizmi i njeriut është makinë e komplikuar, së cilës i nevojitet pushim, e pushimi më i mirë është agjërimi”.

Mjeku Aleksise, i cili mori çmimin Nobel në mjekësi, thotë: “*Shtimi i tepërt i ushqimit çrregullon organet që luajnë funksion të rëndësishëm në organizmin e njeriut, e për këtë ndihet nevoja e agjërimit.*”

Mjeku Robert Bartolo thotë: “*Pa dyshim se agjërimi konsiderohet element kryesor për shkatërrimin e mikrobeve në organizmin e njeriut.*” Gjatë kohës së

agjërimin zhduken shtresat e tepërta të dhjemit, të thatët përthahen, kurse njollat zhduken nga fytyra. Agjërimi është nevojë njerëzore. Me agjërim shërohet edhe trupi edhe shpirti, pa kurrfarë harxhimesh.

Përmbledhje:

1. Agjërimi e pastron trupin e njeriut nga dhjamërat e tepërt, të cilët shkaktojnë sëmundje të vështira me shtimin e tyre. Shëndoshja është një sëmundje e vështirë dhe mënyra më efikase për shërimin e saj është uria.
2. Agjërimi zhduk mbetjet ushqimore të pavlefshme, helmet e tepërta dhe lëngjet e dëmshme në trup. Ai ul nivelin e yndyrës në gjak dhe normalizon qarkullimin e gjakut.
3. Agjërimi ka ndikim mjaft pozitiv ndaj shumë sëmundjeve. Ai ndikon pozitivisht kundër sëmundjeve të aparatit tretës, kundër tensionit të lartë të gjakut dhe kundër çrregullimeve psikologjike dhe emocionale.
4. Agjërimi ka një ndikim mahnitës në ruajtjen e shëndetit, sidomos kur kryhet rregullisht, duke pasur parasysh kohën e tij më të përshtatshme fetarisht dhe nevojën e trupit. Ibn Kajjimi në librin e tij “Mjekësia Profetike” e ka cilësuar këtë gjë. Mjekët në Perëndim i kanë dhënë rëndësi përdorimit të agjërimin si një faktor efikas për shërim. Disa prej tyre kanë thënë: “Përdorimi i urisë si një

faktor kurues është shumë herë më i dobishëm sesa përdorimi i ilaçeve.”

Një tjetër ka thënë: “Agjërimi i një muaji të vetëm në vit largon mbetjet ushqimore të pavlefshme në trup për tërë vitin.”

Këto janë dobitë dhe begatitë më kryesore të agjëritimit në këtë jetë e në jetën tjetër, të cilin Allahu ua ka bërë detyrim muslimanëve agjërimin e tij për çdo vit. Ky është muaji i begatë i Ramazanit.

Dobitë Psikologjike

Përveç dobive shëndetësore, agjërimi sjell edhe *dobi psikologjike*. Agjëruesit i përshkon një gjendje paqeje dhe qetësie. Acarimet personale bien në minimum dhe shkalla e krimit zvogëlohet. Muslimanët këshillohen nga Profeti a.s.: “*Nëse dikush ju fyen apo ju kërcënon, thoni ‘unë jam agjërueshëm’.*” Kjo qetësi psikologjike ndoshta lidhet me një stabilizim më të mirë të glukozës në gjak gjatë Ramazanit, pasi hipoglicemia, pas ngrënies e përkeqëson sjelljen. Gjithashtu një tjetër faktor që ka mjaft ndikim në gjendjen psikologjike të njeriut është namazi i natës. Kjo nuk mundëson thjesht një konsumim më të mirë të ushqimit, por ndihmon edhe në çlirimin e energjisë. Për çdo njësi të namazit çlirohen 10 kalori më shumë. Megjithatë qëllimi se përse ne falemi nuk janë ushtrimet, edhe pse një lëvizje e avashtë e kyçeve që shfrytëzon më shumë kalori është një formë e mirë ushtrimi. Ngjashmërisht, leximi i Kur’anit jo vetëm që sjell qetësi për mendjen dhe zemrën, por përmirëson dhe kujtesën.

Një ndër netët teke të dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit quhet nata e fuqisë, në të cilën engjëjt zbresin grupe-grupe dhe përcjellin tek Zoti faljen dhe adhurimin.

Agjërimi është një vepër e veçantë adhurimi vetëm mes njerëzve dhe Zotit, pasi askush nuk e di në të vërtetë nëse dikush agjëron apo jo. Prandaj Zoti thotë

në një hadith kudsi: *“Agjërimi është për Mua dhe vetëm Unë di si ta shpërblej”*. Në një tjetër hadith, Profeti alejhi selam ka thënë: *“Nëse dikush nuk u jep fund fjalëve dhe veprave të mbrapshta, Allahu nuk ka nevojë që ai të rrijë pa bukë e pa ujë”*.

- Dobitë etiko-morale: Agjërimi është mjete më efikas për kultivimin e vlerave morale tek njeriu për edukimin shpirtëror të tij. Njeriu përbëhet prej shpirtit, i cili anon nga virtytet e larta njerëzore, të udhëhequra nga mendja dhe ndërgjegjia dhe nga ana tjetër përbëhet nga trupi, i cili anon nga përmbushja e pasioneve të udhëhequra nga epshi i tij. Islami me anë të agjërimit nuk ka për qëllim zhdukjen e kënaqësive epshore tek njeriu, por arritjen e sundimit të dëshirave dhe emocioneve të epshit dhe mbajtjen e tyre nën kontroll. Me anë të agjërimit, njeriu arrin të çlirohet nga robëria e pasioneve të tij epshore dhe të përforcohet moralisht dhe të bëhet i vendosur, i fortë, stabil për t’u përballuar vështirësive të ndryshme që i ndodhin në jetë. Andaj, agjërimi mund të konsiderohet se ka arritur qëllimin e duhur kur agjëruesi i ruan gjymtyrët e trupit nga gjërat e ndaluara, si p.sh. kur gjuhën e ruan nga bartja e fjalëve, nga rrena, talljet, fyerjet, përgojimet, dorën e ruan nga vjedhja, sytë nga shikimi i haramit (të ndaluarës), veshët nga dëgjimi i fjalëve të kota dhe të pamoralshme dhe i ruan këmbët nga shkuarja në

vendet e ndaluara të papërshtatshme dhe të gjitha këto duke i zëvendësuar me përmendjen sa më shpesh Allahun xh.sh., ku talljet do të zëvendësohen me seriozitet ndaj fesë islame, përgojimet do të zëvendësohen me fjalë të mira, dhënia të varfërve sadaka, sytë i largon nga e ndaluara dhe këmbët i drejton në vende të mira ku përmendet Allahu xh.sh., siç janë xhamitë dhe tubimet e ndryshme fetare. Mosruajtja e gjymtyrëve të trupit nga veprat e ndaluara shkakton humbjen e shpërblimeve dhe zhvleftësimin e agjërimit.

Lidhur me këtë Muhamedia.s. thoshte: “Agjëruesi është në adhurim derisa të mos e përgojë tjetrin ose të mos e shqetësojë.” Dhe: “Kush nuk i braktis rrenën dhe fjalët e këqija, Allahu nuk ka nevojë për ta lënë ai ngrënien dhe pijen.” Muaji i Ramazanit është rast për pastrimin nga mëkatet. Transmetohet nga Ebu Hurejrar.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush e agjëron muajin e Ramazanit, duke qenë i bindur në besimin islam dhe duke i kryer obligimet islame, do t’i falen gabimet e mëparshme.”

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	5
1. THIRRJA HYJNORE.....	7
2. URTËSIA E AJETIT TË AGJËRIMIT.....	9
3. DEVOTSHMËRIA NË RAMAZAN	12
4. KUPTIMI I DREJTË I AGJËRIMIT	21
5. PËR ATË QË E PËRJETON MUAJIN E RAMAZANIT.....	26
6. HISTORIKU I AGJËRIMIT.....	33
7. DISPOZITAT E AGJËRIMIT.....	37
8. DOBITË E PËRGJITHSHME TË AGJËRIMIT	42
9. KATEGORITË E NJERËZVE NË RAMAZAN	47
10. 10 HAPA SI TË PËRFITOJMË NGA RAMAZANI	50
11. EDUKATA ME RAMAZANIN.....	54
12. UNË JAM AGJËRUESHËM!.....	57
13. E JU, A DO TË NDRYSHONI?!.....	60
14. RAMAZANI DHE JETA	62
15. KUSH ËSHTË FITUESI NË RAMAZAN?.....	64
16. SI TË NDRYSHOJMË NË RAMAZAN.....	66
17. AMNISTIA HYJNORE NË NATËN E KADRIT.....	70
18. MUHAMEDI ALEJHI SELAM DHE SHTIMI I VEPRAVE TË MIRA NË RAMAZAN	75
19. VLERA E NETËVE TË FUNDIT	80
20. ITIKAFI.....	86

21. KËSHILLAT E RAMAZANIT QË PO LARGOHET	91
22. RAMAZANI DHE JUSUFI A.S.....	93
23. LAMTUMIRË RAMAZAN!.....	96
24. PO PAS RAMAZANIT?.....	100
25. MË FAL RAMAZAN!.....	102
26. JETA PAS RAMAZANIT.....	105
27. HAPAT DREJT NJË JETE TË LUMTUR PAS RAMAZANIT	108
28. FESTA E BAJRAMIT	112
29. FETVA TË FIKHUT RRETH ÇËSHTJEVE BASHKËKOHORE MJEKËSORE TË RAMAZANIT.....	122
30. DOBITË SHPIRTËRORE DHE SHËNDETËSORE TË AGJËRIMIT	132